



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

## **RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK**

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional  
në**

**“FIZIOTERAPI”**

**KOLEGJI UNIVERSITAR “REALD”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

**Prof. As. Irena Kola**

**Dr. Enkelelda Sinaj**

Mars/2022

**TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**

**Master Profesional në "Fizioterapi"**

Nr.		
1	IAL aplikues:	Kolegji Universitar "REALD"
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Shkencave Teknike Mjekësore
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master Profesional në "Fizioterapi"
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASR Nr. 449, datë 25.07.2018
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	MASR Nr.2877/4, datë 01/07/2020
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër Nr. 73, date 27.02.2020
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	VBA Nr. 17, datë 24.01.2020
8	Cikli i studimit:	Cikli II
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	1 vit akademik
10	Kreditet në total (ECTS):	60 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	7 (shtatë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	4 PAE/4 PAK
18	Numri i studentëve:	v.a 2020-2021: 6 studentë
19	Komente / të tjera:	Nga 6 studentët e regjistruar, vetëm 1 është diplomuar, 5 të tjerët kanë ndërprerë studimet




## **PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË JASHTËM TE PROGRAMIT**

Programi i Studimit Master Profesional në “Fizioterapi”, në KolegjinUniversitar "Reald" është hapur si program i ciklit të dytë meUrdhër Nr. 449, datë 25.07.2018 tëMASR.Programi është akredituar për herë të pare me Urdhrin Nr. 17 datë 24.01.2020nga ASCAL dhe fitoi akreditimin 1-vjecarme rakomandimedhe me kushtin që, institucioni të mos pranojë e regjistrojë më studentë të rinj në këtë program studimi, deri në riorganizimin e tij, në përmbushje të pikës “e” të konstatimeve të këtij vendimi.

Programi i studimitMaster Profesional në “Fizioterapi”, është organizuar në lëndë e module dhe vlerësuar në kredite, në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë dhe sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve, me kohëzgjatje 1vit-2 semestra, me kohë të plotëdhegjithësej 60 kredite. Ky program organizohet nga Departamenti i Shkencave Teknike Mjekësore, në Fakultetin e Shkencave Mjekësore në Kolegjin Universitar "Reald" dhe u ofrohet studentëve, që kanë përfunduarciklin e parë të studimeve në “Fizioterapi”.

Kolegji Universitar "Reald" në misionin dhe qëllimin e tij ka synuar nëpërmjet këtij programi studimi t’i shërbejë pjesës jugore të vendit, bazuar edhe në nje studim të tregut të punës. Ky program studimit është hartuar për të siguruar formim të specializuar, në gjendje që i diplomuari me master të veprojë me aftësi dhe autonomi profesionale në fushën e rehabilitimit si dhe të sigurojë profesionistë të rinj, që mbështesin zhvillimin shoqëror, ekonomik dhe kulturor të shoqërisë shqiptare dhe përparimin e arsimit dhe kërkimit universitar në nivel kombëtar.

Programi i studimit Master Profesional në “Fizioterapi”përmbush pjesërisht detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin, parë kjo si strukturë, organizim, përbërje të stafit akademik, stafit ndihmës dhe përmbajtjes së programit që ofrohet.GVJ vuri re mospërputhje me aktet ligjore në drejtim të përbërjes e kualifikimit të stafit. Ngaverifikimi i dokumentacionit në dispozicion si dhe vizites në institucionrezulton se stafi akademik i angazhuar në këte program studimi nuk eshte me grada shkencore "Doktor"ose tituj akademik"Profesor", në përputhje me nenin 59 te ligjit 80/2015.Ky program përmbush pjesërisht standardet e miratuara të cilësisë.



## SHKALLA E PËRMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

Programi i studimit Master Profesional në “Fizioterapi” ka përfituar akreditimin 1-vjecar, me Vendim i Bordit të Akreditimit Nr. 17 datë 24.01.2020.

VBA Nr. 17, datë 24.01.2020 “Për akreditimin e parë të programit të studimit të ciklit të dytë, Master professional në “Fizioterapi”, të Kolegjit Univesitar “Reald””, në vendim deklaroi se: “Janë plotësuar pjesërisht standardet” dhe BA vendos akreditimin e programit të studimit vetëm për studentët e regjistruar deri në vitin akademik 2019-2020 dhe që aktualisht ndjekin studimet në këtë program studimi, deri në diplomimin e tyre. **Institucioni të mos pranojë e regjistrojë më studentë të rinj në këtë program studimi, deri në riorganizimin e tij, në përmbushje të pikës "e" të konstatimeve të këtij vendimi.**

Rekomandimet e Bordit të Akreditimit në Vendimin Nr. 17 datë 24.01.2020 dhe përmbushja e tyre nga KU “Reald” janë si vijon:

1. Institucioni, të përditësojë strategjinë e zhvillimit, në përputhje me statusin aktual të Institucionit, fushat kryesore të veprimtarisë, programet dhe planin e zbatimit.

### Plotësimi i Rekomandimit nga KU “Reald”:

Institucioni ka hartuar Strategjinë e Zhvillimit për periudhën 2021-2026 në mënyrë të përgjithëshme. GJV gjatë shqyrtimit të dokumentacionit e vërejtë se, nuk është paraqitur në mënyrë të detajuar si përputhet Strategjia e Zhvillimit e përditësuar, me programin e studimit Master Profesional në “Fizioterapi” dhe planin e zbatimit të tij. Rekomandimi është përmbushur pjesërisht. *Ref. Evidenca. Nr. 55 Strategji zhvillimi 2021-2026*

2. Institucioni, të vendosë si drejtues të njësisë kryesore dhe njësisë bazë, staf brenda moshës së lejuar për punësim, sipas dispozitave ligjore në fuqi.

### Plotësimi i Rekomandimit nga KU “Reald”:

Drejtuesit e njësisë kryesore dhe njësisë bazë të shkencave mjeksore teknike vazhdojnë të jenë të njëjtët në detyrë, të vjetër në moshë dhe me kontratë punësimi me afat 1-vjeçar me të drejtë rinovimi. Rekomandimi është përmbushur pjesërisht. *Ref. Evidenca nr 20 Staf akademik 2020-2021*

3. Institucioni, të marrë masa për shmangien e mbivendosjes së kompetencave ndërmjet njësive të ndryshme dhe të dokumentojë aktivitetin e përditshëm lidhur me takimet, diskutimet, raportimet dhe analizat periodike të njësive/strukturave përgjegjëse për organizimin/ofrimin dhe cilësinë e programit të studimit.

### Plotësimi i Rekomandimit nga KU “Reald”:

Institucioni nuk ka rekrutuar korrektesisht staf të ri akademik, me grada dhe tituj, të specializuar në fushën e programit të studimit Master Profesional në “Fizioterapi”, për mbulimin e ngarkesës mësimore sipas dispozitave ligjore në fuqi. Nuk janë shmangur mbivendosje të kompetencave ndërmjet njësive të ndryshme.

Rekomandimi nuk është përmbushur. *Ref. Evidenca nr 20 Staf i akademik 2020-2021*

- Institucioni, të rishikojë e riorganizojë programin e studimit, në përputhje me VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”.

Plotësimi i Rekomandimit nga KU “Reald”:

Institucioni ka bërë riorganizimin e programit të studimit duke korigjuar ndarjen e lëndëve në kategorit nga A në E, në përputhje me VKM nr 41. Në planin mesimor të riorganizuar në masen nën 20%, nuk është shprehur drejtë ngakresa e lëndës së kategorisi D, praktika profesionale. Në tabelën e kategorizimit të lëndëve Praktika profesionale paraqitet me 6 ECTS, ndërsa në planin mesimor të detajuar ajo paraqitet me 72 ore në auditor, 36 orë seminare dhe 36 ore jashtë auditorit. Praktika profesionale nuk mund të paraqitet e ndarë në kete mënyrë, gjithashtu nuk respektohet shuma 150 orë për 6 ECTS (25 ore për 1 ECTS, në përputhje me VKM 41). Gjithashtu GVJ konstaton se, Institucioni paraqet një plan studimi Master Profesional në “Fizioterapi” të përgjithshëm dhe jo të profilizuar.

Rekomandimi është përmbushur pjesërisht. *Ref. Evidenca nr. 44 Programi mesimor i programit MP në Fizioterapi i riorganizuar në masen nën 20%.*

- Institucioni, të rekrutojë staf të ri akademik, me grada e tituj, të specializuar në fushën e këtij programi studimi, për mbulimin e ngarkesës mësimore nga staf efektiv sipas dispozitave ligjore në fuqi dhe angazhimin në mësimdhënie të stafit akademik me kualifikimin e kërkuar.

Plotësimi i Rekomandimit nga KU “Reald”:

Kolegji nuk ka rekrutuar staf të ri të kualifikuar me grada dhe titujt e nevojshëm. Pjesa më e madhe e lektoreve janë me Msc. Gjithashtu nga analiza e stafit akademik vihet re se lektorët nuk janë të fushës dhe nuk janë të specializuar për të mbuluar mësimdhënien në Master Profesional në “Fizioterapi”.

Rekomandimi nuk është përmbushur. *Ref. Evidenca nr 20 Staf i akademik 2020-2021*

- Institucioni, të përcaktojë si titullarë lëndësh/modulesh, staf akademik të kategorisë “Profesor”.

Plotësimi i Rekomandimit nga KU “Reald”:

Nga analiza e syllabuseve të vëna në dispozicion vihet re mbi vendosje të titullareve të lëndëve. Në stafin e brendshëm kryeson grada Msc dhe jo “Profesor”.

Rekomandimi është përmbushur. *Ref. Evidenca nr 20 Staf i akademik 2020-2021. Evidenca nr. 18 Syllabuset MP Fizioterapi 2020-2021*

- Institucioni, të kategorizojë kontratat e punës në përputhje me Udhëzimet e MASR, Kodin e Punës, aktet rregullatore të KUR si dhe përcaktimet ligjore të LAL në lidhje me kategoritë e personelit akademik në IAL.

Plotësimi i Rekomandimit nga KU "Reald":

Institucioni ka hartuar tre modele kontratash të specifikuara për staf akademik me kohë të plotë, pa afat; staf akademik me kohë të plotë, me afat të caktuar; si dhe staf akademik me kohë të pjesshme; në përputhje me Kodin e Punës. Për drejtuesve të njësisë kryesore dhe njësisë bazë të shkencave mjeksore teknike që janë të përdorur në mënyrë të vjetër në moshë, janë nënshkruar kontratë punësimi me afat 1-vjeçar me të drejtë rinovimi.

Rekomandimi është përmbushur plotësisht. *Ref. Evidenca nr 70 dhe 71 Kontratë pune për staf akademik.*

8. Institucioni, të dokumentojë plotësisht hartimin e miratimin e programeve të reja dhe riorganizimin/përditësimin e programeve ekzistuese, si dhe veprimtaritë e zhvilluara gjatë këtyre proceseve.

Plotësimi i Rekomandimit nga KU "Reald":

Institucioni më datën 28 shkurt 2020 me urdhër të rektorit ka hartuar Planin e Masave për plotësimin e rekomandimeve të Bordit Akademik. KURka hartuar programin e ri mësimor për programin e studimit Master Profesional në Fizioterapi të riorganizuar në masën nën 20%, i cili është vënë në dispozicion në evidencat shqyrtuese.

Rekomandimi është përmbushur plotësisht. *Ref. Evidenca nr. 44 Programi mësimor I programit MP në Fizioterapi të riorganizuar në masën nën 20%. Evidenca nr.46 Plan Masash për zbatimeve të rekomandimeve të BA.*

9. Institucioni, të ruajë, administrojë, analizojë dhe raportojë veprimtaritë në kuadër të realizimit të proceseve akademike dhe administrative në funksion të programit të studimit, në përputhje me aktet e brendshme të miratuara nga ana e institucionit dhe bazën ligjore në fuqi.

Plotësimi i Rekomandimit nga KU "Reald":


Kolegji Universitar "Reald" ka hartuar planin e masave për rekomandimet e BA si dhe ka analizuar përmbushjen e rekomandimeve nga BA. Gjithashtu më datën 22.06.2020 ka raportuar drejtuar MASR mbi riorganizimin e këtij programi studimi. I gjithë dokumentacioni i hartuar është vënë në dispozicion në dosjen shqyrtuese.

Rekomandimi është përmbushur plotësisht. *Evidenca nr.46 Plan Masash për zbatimeve të rekomandimeve të BA. Evidenca nr 74. Shkrese nr 93. datë 22.06.2020 drejtuar MASR.*

10. Institucioni, të shtojë e përditësojë literaturën e parashikuar në syllabuset e këtij programi studimi.

Plotësimi i Rekomandimit nga KU "Reald":

GVJ nga analiza e syllabuseve të këtij programi studimi gjykon se, Kolegji nuk ka shtuar literaturë as nuk e ka përditësuar atë. Në syllabuse vazhdohej të sugjerohej literaturë e varfër dhe jo recente.



Rekomandimi nuk është përmbushur. *Ref. Evidenca nr. 18 Syllabuset MP Fizioterapi 2020-2021.*

11. Institucioni, të shtojë në bibliotekë, titujt në gjuhën shqipe e të huaj, në fushën e fizioterapisë.

Plotësimi i Rekomandimit nga KU "Reald":

IAL nuk ka shtuar në bibliotekë literatur të përditësuar me titujt në gjuhën shqipe dhe të huaj për realizimin e programit të studimit MP në Fizioterapi. Bibloteka e Kolegjit paraqitet shume e varfer me literaturat ne dispozicion të studentëve. GVJ gjykon se, shtesa e litraturës te bera gjate vitit 2020 nuk jane te profilit për programit MP ne Fizioterapi.

Rekomandimi është përmbushur pjesërisht. *Ref. Evidenca nr.36 Libra të rinje të shtuar në Biblotekën e IAL*

12. Institucioni, të ngrejë brenda Institucionit struktura klinike, në funksion të realizimit të këtij programi studimi.

Plotësimi i Rekomandimit nga KU "Reald":

GVJ gjatë vizitës në ambientet e Kolegjit Universitar "Reald" konstatoi se, njësia kryesore nuk disponon një palestër të kompletuar dhe bashkohore për kryerjen e praktikave mësimore. Rekomandimi është përmbushur pjesërisht.

13. Institucioni, të ngrejë e vërë në zbatim një sistem të brendshëm të menaxhimit të të dhënave dhe informacionit për të mundësuar ofrimin e një sërë shërbimesh dhe funksionesh për administrimin dhe menaxhimin e proceseve e aktiviteteve të ndryshme.

Plotësimi i Rekomandimit nga KU "Reald":

IAL ka hartuar Rregulloren për Mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, me vendim senati nr 34 datë 09.05.2020. Gjithashtu ka vënë në dispozicion evidencat per ndryshimin në stafin akademik dhe atë organizative.

Rekomandimi është përmbushur plotësisht. *Ref. Evidenca nr. 66 Vendim i Senatit Akademik nr. 34 date 09.05.2020 - per miratimin e Rregullores per Mbrojtjen e te Dhenave Personale.*

14. Institucioni, të konsolidojë funksionimin e NJSBC, duke u fokusuar në mbledhjen e të dhënave, informacioneve, hartimin e dokumenteve dhe analizave e të kontribuojë në realizimin e proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që vlerësojnë performancën dhe promovojnë e përmirësojnë cilësinë në institucion.

Plotësimi i Rekomandimit nga KU "Reald":

Institucioni me vendim tëRekorit nr 1 date 18.10.2019, ka krijuar strukturën e NJSBC. Kjo strukturë nëpërmjet anketimeve, intervistave dhe pyetesorëve harton e analizon të dhëna dhe merr pjesë në raportime të ndryshme të Kolegjit.

Rekomandimi është përmbushur plotësisht. *Ref. Evidenca nr. 23 Te dhena mbi perberjen e NJSBC - Vendim nr. 1 dt.18.10.2019 - Miratim strukture NJSBC dhe ZBNJ.*

15. Institucioni, të standardizojë procedurat e aplikuara në hartimin, administrimin dhe arkivimin e dokumentacionit zyrtar (në formë elektronike apo në letër), në përputhje me bazën ligjore dhe aktet nënligjore.

Plotësimi i Rekomandimit nga KU "Reald":

Institucioni me vendim të Senatit nr.36 datë 01.06.2020 ka miratuar Rregulloren Standardizimit të Procedurave për hartimin, administrimin dhe arkivimin e dokumentacionit zyrtar në formë elektronike apo në letër.

Rekomandimi është përmbushur plotësisht. *Ref. Evidenca nr. 62 Rregullore e Standardizimit te Procedurave per hartimin administrimin e dokumentacionit zyrtar.pdf*

16. Institucioni, të mbështesë dhe përfshijë studentët në vendimmarrje dhe jetën akademike të kolegjit, të analizojë dhe marrë parasysh propozimet dhe kontributet e tyre e ti bëjë ato publike, si dhe të bëjë funksionale Zyrën e Karrierës.

Plotësimi i Rekomandimit nga KU "Reald":

Institucioni ka përfshirë studentët në cdo vendimmarrje. Duke i përfshirë ata në Senat dhe në NJSBC. Gjithashtu është bërë funksionale zyra e Karrierës nëpërmjet studimit të punësimit të studenteve në tre vitet e fundit.

Rekomandimi është përmbushur plotësisht. *Ref. Evidenca në 26. Te dhena mbi punësimin e studentëve të diplomuar 2016-2019.*

GVJ konstaton se Kolegji Universitar "Reald" nuk i ka përmbushur plotësisht disa nga rekomandimet e lëna nga akreditimi i parë. Nga vlerësimi u evidentuan persëritje kompetencash ndërmjet njësive dhe mos dokumentim të raportimeve midis strukturave për cilësinë e programit të studimit:

Drejtuesist e njesisë kryesore dhe njesisë bazë të shkencave mjekësore teknike vazhdojnë të jenë të njejtët në detyrë, të vjeter në moshë, por me kontrate punësimi me afat 1-vjecar me të drejtë rinovimi.

Institucioni nuk ka rekrutuar korrektesisht staf të ri akademik, me grada dhe tituj, të specializuar në fushën e këtij programi studimi, për mbulimin e ngarkesës mësimore sipas dispozitave ligjore në fuqi. IAL nuk ka shtuar në bibliotekë literaturë recent me tituj në gjuhën të huaj.





## PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Raporti i Vlerësimit të Jashtëm për programin e studimit Master Profesional në "Fizioterapi" në Kolegjin Universitar "Reald", u përpilua nga dy profesorë me përvojë dhe ekspertë të fushës: Prof.As Irena Kola dhe Dr. Enkeleda Sinaj. Gjatë gjithë procedurës, grupi i eksperteve të jashtëm u asistua nga përfaqësi i ASCAL, Msc. Erjon Xhako.

Ekspertët e vlerësimit bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga Kolegji Universitar "Reald" dhe ligjin 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", në VKM Nr.41 datë 24.01.2018 të ndryshuar, në Udhëzimin Nr. 1 datë 14.1.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësisve kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", VKM Nr. 531, kanë kryer vlerësimin e programit të studimit Master Profesional në "Fizioterapi".

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vizitoi Kolegjin Universitar "Reald" në datë 4 dhe 5 Tetor 2021 dhe u takua me përfaqësues për të kuptuar dhe pyetur më tej anëtarët kryesorë të stafit në lidhje me Vlerësimin e Brendshëm të paraqitur nga Institucioni dhe gjithë dokumentacionin mbështetës. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm është konsultuar me njëri-tjetrin për të gjitha gjetjet dhe konkluzionet e paraqitura në këtë raport dhe kanë rënë dakord së bashku për vlerësimin e vertetë dhe të sigurtë të standardeve.



Më datë 16.02.2022, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 51/3 Prot, datë 16.02.2022 dërgohet në Institucion Draft- Raporti i vlerësimit të jashtëm. IAL përcolli komentet përmes AMS më datë 22.02.2022 dhe me shkresë zyrtare Nr. 69 Prot, datë 22.02.2022 me lëndë "Komente mbi RVJ në programin Master Profesional në Fizioterapi".

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) pasi u njohë me komentet e institucionit mbi Draft-Raportin sqaron si vijon:

1. **Për komentin e IAL, numër 1:** GVJ i qëndron argumentimit të dhënë në brendësi të raportit dhe si rrjedhojë, **raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**
2. **Për komentin e IAL numër 2:** GVJ i qëndron argumentimit të dhënë në brendësi të raportit dhe si rrjedhojë, **raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**
3. **Për komentin e IAL, numër 3:** GVJ i qëndron argumentimit të dhënë në brendësi të raportit dhe si rrjedhojë, **raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**
4. **Për komentin e IAL, numër 4:** GVJ i qëndron argumentimit të dhënë në brendësi të raportit dhe si rrjedhojë, **raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**
5. **Për komentin e IAL, numër 5:** GVJ i qëndron argumentimit të dhënë në brendësi të raportit dhe si rrjedhojë, **raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**




6. **Për komentin e IAL, numër 6:** GVJ i qëndron argumentimit të dhënë në brendësi të raportit dhe si rrjedhojë, **raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**
7. **Për komentin e IAL, numër 7:** GVJ i qëndron argumentimit të dhënë në brendësi të raportit dhe si rrjedhojë, **raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**
8. **Për komentin e IAL, numër 8:** GVJ i qëndron argumentimit të dhënë në brendësi të raportit dhe si rrjedhojë, **raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**
9. **Për komentin e IAL, numër 9:** GVJ i qëndron argumentimit të dhënë në brendësi të raportit dhe si rrjedhojë, **raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**
10. **Për komentin e IAL, numër 10:** GVJ i qëndron argumentimit të dhënë në brendësi të raportit dhe si rrjedhojë, **raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**
11. **Për komentin e IAL, numër 11:** GVJ i qëndron argumentimit të dhënë në brendësi të raportit dhe si rrjedhojë, **raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**
12. **Për komentin e IAL, numër 12:** GVJ i qëndron argumentimit të dhënë në brendësi të raportit dhe si rrjedhojë, **raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**
13. **Për komentin e IAL, numër 13:** GVJ i qëndron argumentimit të dhënë në brendësi të raportit dhe si rrjedhojë, **raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**
14. **Për komentin e IAL, numër 14:** GVJ i qëndron argumentimit të dhënë në brendësi të raportit dhe si rrjedhojë, **raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**
15. **Për komentin e IAL, numër 15:** GVJ i qëndron argumentimit të dhënë në brendësi të raportit dhe si rrjedhojë, **raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**
16. **Për komentin e IAL, numër 16:** GVJ i qëndron argumentimit të dhënë në brendësi të raportit dhe si rrjedhojë, **raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**
17. **Për komentin e IAL, numër II:** GVJ i qëndron argumentimit të dhënë në brendësi të raportit dhe si rrjedhojë, **raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**



**VLERËSIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER  
PROFESIONAL NË “FIZIOTERAPI”**

**I. OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT**

<b>Standardi I.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi të ciklit të dytë “Master profesional” në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1</b> Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	<p>Programi i studimit i ciklit të dytë “Master profesional” në “Fizioterapi” në IAL Reald, është hapur me Urdhër nr. 449, datë 25.07.2018 të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Programi i studimit ka përfituar akreditimin 1-vjeçar, me Urdhrin Nr. 17 datë 24.01.2020 dhe kushtin që, Institucioni të mos pranojë e regjistrojë më studentë të rinj në këtë program studimi, deri në riorganizimin e tij, në përmbushje të pikës "e" të konstatimeve të paraqitura në vendimin nr. 17 datë 24.01.2020. Programi i studimit është hartuar konform statutit të Kolegjit Universitar "Reald", në përputhje me bazën ligjore të miratuar nga institucionet e Republikës së Shqipërisë, që rregullojnë veprimtarinë në fushën e arsimit të lartë, të cilat nuk bien ndesh me interesat kombëtare.</p> <p><i>Ref. Dok.nr2 Statutii Kolegjit Universitar Reald, neni 2, 4.</i></p>
<b>Kriteri 2</b> Programet e studimit synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>Duke analizuar Statutin dhe Misionin e Kolegjit Universitar "Reald" vihet re se, programi i studimit Master Profesional në “Fizioterapi” synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare, në përgatitjen e fizioterapisteve të ardhshëm, sic janë: respektimi i të drejtave themelore të njeriut, barazinë në shoqëri, traditat dhe simbolet kombëtare.</p> <p><i>Ref. Dok.nr.2 Statuti i Kolegjit Universitar Reald, neni 2, 4 dhe Dok.nr3 Strategji zhvillimi 2021-2026.</i></p>
<b>Kriteri 3</b> Programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	<p>Referuar Statutit të Kolegjit Universitar neni 4, programi i studimit Master Profesional në “Fizioterapi” është në përputhje me misionin dhe fushën e veprimtarisë të tij. Duke analizuar misionin dhe qëllimin e Kolegjit Universitar "Reald", shprehur edhe në rregullore, marrëveshje dhe objektiva të dokumentuara vihet re se, Programi Master Profesional në "Fizioterapi" është përgatitur në përputhje me to. Gjithashtu, nga vërehet qartë përpjekja e IAL, për të dhënë kontributin e vet në zhvillimin cilësor të arsimit të lartë.</p> <p>Programi i studimit mbështet zhvillimin shoqëror, ekonomik dhe</p>



	<p>kulturor të shoqërisë shqiptare. Programi i studimit është hartuar më qëllimin për të formuar specialist të lartë duke kontribuar në rritjen e standadeve në rajonin e jugut dhe të radhise Kolegjin Universitar Reald mes Institucioneve cilësore të arsimit të lartë në vendin tone.</p> <p><i>Ref. Dok.nr.2 Statuti, Dok. nr 55 Strategji zhvillimi 2021-2026</i></p>			
<p><b>Kriteri 4</b> Programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.</p>	<p>Programi i studimit MP në “Fizioterapi” është përzgjedhur dhe hartuar për t’iu përshtatur e përgjigjur zhvillimit ekonomik të vendit dhe të plotësojnë nevojat intelektuale në të ardhmen. Hartimi i tij u nxit nga një nevojë e shoqërisë në kushtet e reja të tregut, por jo kërkesës ndaj të diplomuarëve në fushat mjeksore pranë KUR. Nga analiza e numrit të studentëve vihet re se, për vitin akademik 2020-2021 rezulton vetëm 1- student i diplomuar në këtë program. 1- student për vitin akademik 2017-2018 dhe 2- student për vitin 2018-2019. Studentët e regjistruar ndërvite nuk e kalonin 6 student.</p> <p><i>Ref. Dok. Nr.55 Strategji zhvillimi 2021-2026, Dok. Nr.51 Studim Tregu në fushën e shëndetësisë. Dok. Nr 32 Studentët e diplomuar 2019-2020 dhe 2020-2021</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
			X	

<p><b>Standardi I.2</b>  <b>Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.</p>	<p>Referuar Strategjisë të Zhvillimit Insitucional të Kolegjit Universitar "Reald" për periudhën 2021-2026 miratuar nga Senati Akademik me vendim nr 36, u vu re se në të nuk janë paraqitur në mënyrë të detajuar se si përputhet Strategjia e Zhvillimit e përditësuar, me programin e studimit Master dhe planin e zbatimit të tij.</p> <p><i>Ref. Dok. nr 55 Strategji zhvillimi 2021-2026</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimet prioritare akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	<p>Programi i studimit është hartuar në përputhje me Statutin e Kolegjit Universitar "Reald", me Rregulloren e Fakultetit të Shkencave të Mjeksisë dhe Rregulloren e Brendshme të IAL. Përmbajtja e tij synon të japi njohuri bazë dhe të thelluara, mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme dhe specifike në fushën e arsimit të trajnimit profesional të kryer.</p> <p><i>Ref. Dok. Nr. 2 Statuti i Kolegjit Universitar Reald.</i>  <i>Ref. Dok. Nr. 4 Rregullore e përgjithëshme e IAL neni 27</i></p>

	<i>Ref.Dok.nr 5 Rregullore e Fakultetit të Shkencave të Mjeksisë.</i>			
<b>Kriteri 3.</b> Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit.	Organizimi I programit të studimit është në përputhje me VKM nr. 41, datë 24.01.2018, “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL”. Programi i studimit ka të përcaktuar emërtimin “Fizioterapi”, organizimin e tij me kohë të plotë dhe kohëzgjatje 1-vit, sipas kriterëve ligjore të parashikuara.  <i>Ref. Dok.46 Programi Mesimor i programit MP ne Fizioterapi- i riorganizuar në masën nën 20%.</i>			
<b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit të ciklit të dytë “Master profesional” hartohen e zhvillohen në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit.	Programi Master Profesional në "Fizioterapi" është hartuar për t'iu përshtatur e përgjigjur zhvillimit e interesave të vendit tonë e në vecanti zonës jugore. Nga vizita e GVJ në ambientet e IAL u vu re se, hartimi i tij nuk u nxit nga një nevojë e kërkesë të lartë ndaj të diplomuarëve në fushat mjeksore. Gjithsej programi për vitin akademik 2020-2021 nga 6 studentë të regjistruar, 5 prej tyre i kishin ndërprerë studimet duke u çregjistruar dhe vetëm një ishte diplomuar.  <i>Ref. Dok. nr 55 Strategji zhvillimi 202-2026,</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

### Standardi I.3

**Programet e studimit “Master profesional” synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me nevojat dhe kërkesat e tij.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit “Master profesional” kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.	GVJ gjykon se, programi synon të pajisë kryesisht studentët me formim dhe kompetenca profesionale në fushën e shkencave mjeksore, nëpërmjet dhënies se njohurive teorike dhe praktike, të aftë për të punuar si fizioterapist, menaxherë dhe për realizimin e studimeve të avancuara për ciklet e tjera.  Nga dokumentacioni shqyrtues si dhe vizita në ambientet e Kolegjit, u vënë re limite në profilizim të programit, mangësi të stafit akademik me profil në fushën e fizioterapisë, mangësi të ndarjes së ngarkesës të stafit akademik si dhe caktimi i tij, pasi në dokumente të ndryshme të sjella nga IAL, si dhe nga takimit me stafin akademik, arrijme në përfundime të ndryshme për stafin dhe pozicionin e tij.  Gjithashtu, stafi akademik i programit nuk ka kualifikimin e duhur që kërkon legjislacioni, pasi vihet re se janë të angazhuar në këtë program studimi, 7 staf akademik efektiv me kualifikimin Msc dhe Mp.  <i>Ref. Dok. nr 55 Strategji zhvillimi 2021-2026</i>

	<p><i>Ref. Dok.46 Programi Mesimor i programit MP ne Fizioterapi- i riorganizuar në masën nën 20%.</i></p> <p><i>Ref. Tabelat permbledhese per Aneks_RVB - MP. Fizioterapi. pdf.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Programi i studimit është hartuar duke pasur në konsideratë zhvillimin ekonomik dhe trendin e tregut të punës në Shqipëri, por jo atë ndërkombëtar. GVJ shqyrtoj studimin e tregut të punës të paraqitur nga IAL në nivel rajonal dhe kombëtar, si dhe analizën e punësimit për studentet e diplomuar, por nuk u ve re asnjë kontratë bashkpunimi me institucione të ndryshme punëmarrese për punësimin e të diplomuarëve nga ky program. IAL nuk kishte bërë një studim tregu të punës të mirëfilltë.</p> <p><i>Ref. Dok. nr. 53 Studim Tregu në fushen e shendetësise.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Objektivat formues struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet garantojnë përfitim të dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Plani mësimor i programit të studimit Master Profesional në “Fizioterapi” për vitin 2019-2020 i paraqitur në dokumentacionin shqyrtues, parashikon përfitime të njohurive teorike dhe atyre të aspektit praktik. Struktura e programit nuk ishte në përputhje me VKM nr. 41 datë 24.01.2018. Sipas vendimit praktikant profesional duhet të jenë në kategorin D, ndërsa në plan mesimor ato ishin shfaqur në kategorin E. Me vendim Senati nr. 32 datë 15.04.2020 IAL ndryshoi në masën më pak se 20% Planin Mësimor duke riorganizuar kategoritë sipas VKM nr. 41.</p> <p>GVJ gjykon se në planin e riorganizuar rezultatet e pritshme të të nxëniet nuk garantojnë plotësisht përfitim të dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve. Stafi akademik i programit me profil në fushën e rehabilitimit, ortopedisë dhe pediatrikës është i limituar dhe ka mangësi të theksuar në ndarje të ngarkesës mësimore si dhe mungesës së gradës shkencore “Profesor”.</p> <p><i>Ref. Dok. nr. 13 Plani Mesimor MP ne Fizioterapi 2019-2020</i></p> <p><i>Ref. Dok. Nr 60 Plani Mesimor i programit MP ne Fizioterapi-i riorganizuar.</i></p> <p><i>Ref. Tabelat permbledhese per Aneks_RVB - MP. Fizioterapi. pdf.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimeve përafrohen me programe studimi të ngjashme të ofruar nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimit të studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.</p>	<p>Kolegji ofron mundësi për transferime të studentëve në vite të ndërmjet e midis programeve të të njëjtit cikël, brenda vetë institucionit apo institucioneve të ndryshme të arsimit të lartë kombëtare, por jo atyre ndërkombëtare. Këto transferime bëhen mbi bazën e kërkesës së studentit në përputhje me procedurat, kuota dhe kriteret e miratuara. Të gjitha transferimet miratohen nga Rektori.</p>

	<p>Për procedurat e transferimeve, me vendim të rektoratit ngrihet komisioni përkatës në nivel Kolegji. Përbërja e komisionit ndryshohet me vendim të Rektorit. Në çdo departament, me urdhër të Dekanit ngrihen komisionet e vlerësimit të cilat miratohen prej tij.</p> <p><i>Ref. Dok. Nr. 4 Rregullore e përgjithshme e IAL.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit hartohen në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara mbështeten në përvojën disavjeçare të institucionit dhe praktikat e mira të vendeve evropiane.</p>	<p>Programi i studimit është hartuar më qëllim për të qenë i pajtueshëm me prirjet kryesore të zhvillimit të arsimit të lartë në Europë, e në vecanti duke qenë në përputhje me procesin e Bolonjes. Të gjitha modulet janë të kodifikuara dhe të vleresuara në kredite (ECTS), viti akademik i planit të studimit përmban 60 ECTS, por numri gjithësej i orëve mësimore nuk është paraqitur në përputhje me VKM nr.41 dhe direktivat e BE-së. GVJ gjykon se, në planin mësimor të ri indryshuar në masën nën 20%. (25 ore për 1 ECTS).</p> <p><i>Ref. Dok. nr 55 Strategji zhvillimi 2021-2026.</i> <i>Ref. Dok.46 Programi Mesimor i programit MP ne Fizioterapi- i riorganizuar në masën nën 20%.</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e ciklit të dytë "Master profesional" përfshijnë aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.</p>	<p>Nëdokumentit nr.29 Marreveshjet e bashkepunimit me Institucionet për kryerjen e praktikave mësimore, të vënë në dispozicion nga KUR, radhiteshin institucione kombëtare dhe të huaja për zhvillimin e praktikave mësimore. E vetmja marrëveshje ishte ajo me Universitetin e Foggia në Itali e cila ishte më shumë në formën e marreveshjes kuader, ku nuk specifikohet asgjë në vecanti lidhur me kryerjen e praktikave apo kohëzgjatjen e saj. Nuk u prezantua asnjë evidence ku të vërtetohej suksesi i këtyre marrëveshjeve. Gjithashtu, IAL kishte nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi për kryerjen e praktikave mësimore, vetëm me dy institucione kombëtare: Klinikën Fizio Life dhe Spitalin e Vlorës.</p> <p><i>Ref. Dok. Nr 29 Marreveshjet e bashkepunimit me institucionet per kryerjen e praktikave mesimore.</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Në varësi të profilit të institucionit, në programet e ciklit të dytë "Master profesional" mund të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj dhe ndërkombëtarizimin.</p>	<p>Në Planin e Zhvillimit 2021-2026 IAL paraqet si objektive strategjike, tërealizoj programe studimi në gjuhë të huaj, por aktualisht IAL nuk paraqet asnjë lëndë në gjuhë të huaj. Programi është i hartuar në gjuhën shqipe dhe nuk ka ndonjë modul në gjuhë të huaj.</p> <p><i>Ref. Dok. nr 55 Strategji zhvillimi 2021-2026.] [Ref. Dok.46 Programi Mesimor i programit MP ne Fizioterapi- i riorganizuar në masën nën 20%.</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Programet e ciklit të dytë "Master profesional" mund</p>	<p>Programi i studimit ofrohet si përgjigje e kërkesës së tëdiplomuave në Bachelor për të vazhduar studimet e ciklit të dytë në këtë drejtim dhe</p>

të hapen përkohësisht në funksion të plotësimit të nevojave për personel të kualifikuar në një drejtim të caktuar.	vlerësimi të stafit drejtues për nevojën e plotësimit të institucionit me programe në këtë fushë studimi. Gjithashtu programi i studimit synon të plotësojë nevojat e Jugut të Vendit për specialistë në fushën e fizioterapise.		
	Ref. Dok. nr 55 Strategji zhvillimi 2021-2026		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
		X	

**Standardi I.4**  
**Programet e ciklit të dytë “Master profesional” janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Në dokumentacionin e shqyrtuar, është paraqitur ngarkesa mësimore në orë që mbulojnë lektorët e përfshirë në departament. Referuar dokumentacionit në dispozicion mbi stafin akademik për programin e studimit GVJ konstaton se janë angazhuar në departament gjithsej 11 pedagogë të përfshirë si personel akademik efektiv (staf të brendshëm) dhe 7 pedagogë, personel akademik me kontratë (të jashtëm). Gjithashtu nga analiza e ndarjes së lektorëve për lëndë rezultoi: PAE 11 (1 Prof.Dr, 3 Dr., 1 MP, 6 Msc.) dhe 7 PAK (1 Prof. Dr., 2 Dr., 4 Msc). GVJ gjykon se, institucioni shfaq mangësi të theksuara në kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi Master Profesional në “Fizioterapi”. Titujt dhe gradat e stafit akademik nuk ishin në kualifikimin e duhur, sipas kërkesës ligjore për të pasur të paktën gradën Dr.  Ref. Dok.nr23. Lista e stafit akademik të angazhuar në MP në Fizioterapi 2018-2019 dhe 2019-2020. Ref. Dok. 121 Tabelat përmbledhese për Aneks_RVB - MP. Fizioterapi.
<b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Në hartimin e programit të studimit është marrë parasysh, që fusha e përgjithshme duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të Fakultetit të Shkencave Mjekësore. Programi i studimit nuk paraqitet shumë i profilizuar, ai paraqitet i përgjithshëm dhe me mungesë të lëndëve në rehabilitim neurologjik.  Ref. Dok.nr. 46 Programi Mesimor i programit MP në Fizioterapi- i riorganizuar në masën nën 20%.
<b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të	Programi i studimit është hartuar në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të njësisë kryesore: Fakultetit të Shkencave Mjekësore.



<p>studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Fusha e përgjithshme, por jo ajo specifike, e programeve të studimit është në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programet e studimit.</p> <p><i>Ref. Dok.nr. 46 Programi Mesimor i programit MP ne Fizioterapi- i riorganizuar në masën nën 20%.</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Në rastet kur institucioni ofron program të ciklit të dytë “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.</p>	<p>Institucioni ofron program të ciklit të dytë “Master profesional” në një drejtim specifik Fizioterapi, brenda profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet vetem nga institucioni, jo nga institucionet partnere.</p> <p><i>Ref. Dok.nr. 46 Programi Mesimor i programit MP ne Fizioterapi- i riorganizuar në masën nën 20%.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p><b>X</b></p>	

**Standardi I.5**


**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Në dokumentacionin e vënë në dispozicion tregohet se institucioni ka krijuar grupin e vlerësimit të brendshëm për programin e studimit, në lidhje me modelimin, mbikëqyrjen dhe mirëmbajtjen (Urdhëri nr 4 date 27.07.2021 nga Kolegji Universitat Reald).</p> <p>Nuk u dokumentua apo u sqarua ndarja e detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p> <p><i>Ref. Dok. Nr. 12 12. Urdher i Rektorit per GVB per programim Mp. Fizioterapi</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.</p>	<p>Institucioni ne dokumentacionin e vënë në dispozicion liston nje marreveshje bashkepunimi me Universitetin e Fogia-s. Kjo marreveshje nuk ka asnje afat apo detaj lidhur me realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve. Ndërsa, marreveshjae bashkëpunimi më Universitetin e Tiranës është e pavlereshme, ka skaduar me datën 10.04.2021.</p> <p><i>Ref. Dok. Nr 27 Marreveshja e bashkepunimit me Universitetin e</i></p>


	<p><i>Fogias.</i>  <i>Ref. Dok. Nr. 30 Marreveshje bashkepunimi me Universitetin e Mjekesise Tirane.</i></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Për realizmin e programeve të ciklit të dytë “Master profesional”, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute, kompani, të fushës përkatëse, për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>Intitucioni në dokumentacionin e vënë në dispozicion liston marrëveshje bashkepunimi për kryerjen e praktikave mësimore me institucione shqiptare dhe të huaja. Nga verifikimi i dokumentacionit prezantues shumica e këtyre bashkëpunimeve nuk ishin të finalizuara me kontrate, që të konsiderohen nga GVJ si dhe nuk përfshin programin e studimit Master Profesional në Fizioterapi. <i>Për shembull marrëveshja e bashkëpunimit me Spitalin Rajonal Vlorë, përfshinte vetëm studentët e ciklit Bachelor “Teknike Laboratori” dhe jo ata të programit të studimit në fjalë.</i></p> <p><i>Ref.Dok. 29 Marreveshje bashkepunimi me Spitalin Rajonal Vlore Ref. Dok. 31 Marreveshjet e bashkepunimit me institucionet per kryerjen e praktikave mesimore.</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimit që ofron.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në ambientet e IAL vuri re se, praktika mësimore kryheshin në kabinetin e Fizioterapisë brenda institucionit dhe Klinikën Fizio Life. Ambientet e kabinetit ishin modeste për zhvillimin e praktikave mësimore.</p> <p><i>Dok. 31 Marreveshjet e bashkepunimit me institucionet per kryerjen e praktikave mesimore</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>IAL nuk e përmbush këtë kriter, pasi nuk ka patur të tilla aktivitete për programin Master Profesional në Fizioterapi.</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Në mënyrë periodike njësi përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Nga dokumentacioni në dispozicion dhe intervistat e bëra gjatë vizitës në aktivitet nuk rezulton se Departamenti apo Njësia përgjegjëse të raportoj lidhur me efikasitetin e përfitimeve që rrjedhin nga bashkëpunimi me institucione të tjera.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	
<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER PROFESIONAL

<b>Standardi II.1 Programet e studimit organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.</b>																
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>															
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional ne Fizioterpi është organizuar në lëndë e module dhe vlerësuar në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Pasqyruar këto edhe ne Statut dhe Rregulloret e Fakultetit dhe programit.</p> <table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <tr> <td style="text-align: center;">A</td> <td>LËNDË BAZE</td> <td style="text-align: center;">5% - 10% (kredite)</td> </tr> <tr> <td style="text-align: center;">B</td> <td>LËNDË KARAKTERIZUESE</td> <td style="text-align: center;">30% - 40% (kredite)</td> </tr> <tr> <td style="text-align: center;">C</td> <td>LËNDË NDËRDISIPLINORE/INTEGRUE SE</td> <td style="text-align: center;">20% - 30%(kredite)</td> </tr> <tr> <td style="text-align: center;">D</td> <td>LËNDË PLOTËSUESE</td> <td style="text-align: center;">10%(kredite)</td> </tr> <tr> <td style="text-align: center;">E</td> <td>DETYRIME PËRMBYLLËSE</td> <td style="text-align: center;">10%-20%(kredite)</td> </tr> </table> <p><i>Ref. Dok.nr. 46 Programi Mesimor i programit MP ne Fizioterapi- i riorganizuar në masën nën 20%</i></p>	A	LËNDË BAZE	5% - 10% (kredite)	B	LËNDË KARAKTERIZUESE	30% - 40% (kredite)	C	LËNDË NDËRDISIPLINORE/INTEGRUE SE	20% - 30%(kredite)	D	LËNDË PLOTËSUESE	10%(kredite)	E	DETYRIME PËRMBYLLËSE	10%-20%(kredite)
A	LËNDË BAZE	5% - 10% (kredite)														
B	LËNDË KARAKTERIZUESE	30% - 40% (kredite)														
C	LËNDË NDËRDISIPLINORE/INTEGRUE SE	20% - 30%(kredite)														
D	LËNDË PLOTËSUESE	10%(kredite)														
E	DETYRIME PËRMBYLLËSE	10%-20%(kredite)														
<p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimit të ciklit të dytë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionesh e specialitetesh.</p>	<p>Program i studimit përgatit fizioterapistë, por gjithashtu ai synon të pajisë studentët me njohuri dhe shprehi të vecanta, që do t'u shërbejnë atyre në punësim. Në program janë parashikuar lëndë e module të etikës, menaxhimit shëndetsor dhe psikologji.</p> <p><i>Ref. Dok.nr. 46 Programi Mesimor i programit MP ne Fizioterapi- i riorganizuar në masën nën 20%</i></p>															
<p><b>Kriteri 3</b> Programet e studimit të ciklit të dytë japin njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Nëpermjet këtij programi synohet që të diplomuarit të jenë në gjendje te punojnë në skuader, të përbërë nga profesionistë të fushave të ndryshme. Gjithashtu synohet që të diplomuarit të jene në gjendje për të praktikuar në mënyrë të pavarur terapitë e sakta për riedukimin funksional të pacientëve.</p> <p><i>Ref. Dok.nr. 46 Programi Mesimor i programit MP ne Fizioterapi- i riorganizuar në masën nën 20%.</i></p>															
<p><b>Kriteri 4</b> Programet e studimit të ciklit të dytë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për</p>	<p>Programi i studimit Master në “Fizioterapi” zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca jo fortë të thelluara për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar fizioterapeutike. GVJ konstaton mungesën e lëndëve të profilit për fitimin e aftësive të</p>															



<p>zgjdhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>avancuara në këto fusha të specializuar. Permendim këtu lëndë në fushën e rehabilitimit neurologjike.</p> <p><i>Ref. Dok.nr. 46 Programi Mesimor i programit MP ne Fizioterapi- i riorganizuar në masën nën 20%</i></p>															
<p><b>Kriteri 5</b> Programet e studimit të ciklit të dytë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Hartimi i programit është në përputhje me VKM Nr.41, datë 24.01.2018. Në të janë paraqitur:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Kreditet, sipas Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS);</li> <li>Kontrolli i dijeve dhe instrumentet e vlerësimit;</li> <li>Objektivat formues dhe kompetencat profesionale;</li> <li>Veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit tëstudimit;</li> <li>Kategoritë e veprimtarive formuese, që karakterizojnë njëprogramstudimi;</li> <li>Planin mësimor;</li> <li>Kuotat e pranimit dhe grupet mësimore;</li> <li>Programin lëndor (Syllabus-et);</li> <li>Profilin e programit;</li> <li>Diplomën dhe suplementin.</li> </ol> <p><i>Ref. VKM-së nr.41 date 24.01.2018.</i></p>															
<p><b>Kriteri 6</b> Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët/modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Programi i studimit Master në “Fizioterapi” ka të përcaktuar veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët/modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite. Bazuar në VKM nr. 41 disiplinat janë grupuar A, B, C, D, E dhe janë shprehëndarësi më poshtë:</p> <table border="1" data-bbox="580 1375 1362 1666"> <tr> <td>A</td> <td>LËNDË BAZE</td> <td>6 (ECTS) 10%</td> </tr> <tr> <td>B</td> <td>LËNDË KARAKTERIZUESE</td> <td>24 (ECTS) 40%</td> </tr> <tr> <td>C</td> <td>LËNDË NDËRDISIPLINORE/INTEGRUESE</td> <td>15 (ECTS) 25%</td> </tr> <tr> <td>D</td> <td>LËNDË PLOTËSUESE</td> <td>6 (ECTS) 10%</td> </tr> <tr> <td>E</td> <td>DETYRIME PËRMBYLLËSE</td> <td>9 (ECTS) 15%</td> </tr> </table> <p>Vihet re se, pesha e dhënë në program të lëndëve bazë dhe karakterizuese (A+B) zë 50% të tij, pra respektohet raporti sipas VKM nr.41.</p> <p><i>Ref. Dok. Nr. 44 Plani Mesimor MP ne Fizioterapi.</i></p>	A	LËNDË BAZE	6 (ECTS) 10%	B	LËNDË KARAKTERIZUESE	24 (ECTS) 40%	C	LËNDË NDËRDISIPLINORE/INTEGRUESE	15 (ECTS) 25%	D	LËNDË PLOTËSUESE	6 (ECTS) 10%	E	DETYRIME PËRMBYLLËSE	9 (ECTS) 15%
A	LËNDË BAZE	6 (ECTS) 10%														
B	LËNDË KARAKTERIZUESE	24 (ECTS) 40%														
C	LËNDË NDËRDISIPLINORE/INTEGRUESE	15 (ECTS) 25%														
D	LËNDË PLOTËSUESE	6 (ECTS) 10%														
E	DETYRIME PËRMBYLLËSE	9 (ECTS) 15%														
<p><b>Kriteri 7</b> Programet e studimit parashikojnë ngarkesën në kredite</p>	<p>Praktika profesionale e parashikuar në program ka 6 kredite dhe zë 10% të ngarkesës totale te programit, në përputhje me VKM nr.41, por</p>															



të dedikuara për praktikën profesionale, laboratorike e klinike me ekuivalentim sipas përcaktimeve në aktet nënligjore kombëtare dhe në përputhje me direktivat evropiane.	vihet re se ngarkesa në orë nuk është paraqitur drejtë në Planin Mësimor të riorganizuar për vitin 2020-2021. Praktika profesionale dyhet të kishte 150 orë për 6 ECTS (pra 25 orë për cdo 1 ECTS).		
	<i>Ref. Dok. Nr. 44 Plani Mesimor MP ne Fizioterapi 2020-2021 I riorganizuar me ndryshime me pak se 20%.</i>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
		X	

<b>Standardi II.2</b>	
<b>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	Si njësia kryesore ashtu dhe ajo bazë përgjegjëse për programin e studimit Master Profesional në Fizioterapi përmbushin pjesërisht detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin, parë kjo si strukture, si organizim, si përberje të stafit etj. Programi i studimit ka përfituar akreditimin 1-vjeçar, me Urdhrin Nr. 17 datë 24.01.2020 dhe kushtin që, Institucioni të mos pranojë e regjistrojë më studentë të rinj në këtë program studimi, deri në riorganizimin e tij, në përmbushje të pikës "e" të konstatimeve të paraqitura në vendimin nr. 17.  <i>Ref. Dok.nr. 102-116 Cv-stafi akademik], Dok. Nr. 13 Plani Mesimor MP ne Fizioterapi.</i>
<b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	Fakulteti i Shkencave Teknike Mjekësore pranë KUR përbëhet nga: Departamenti i Shkencave Teknike Mjekësore, Departamenti I Stomatologjisë dhe Departamenti i Farmacisë. Njësia bazë, Departamenti i Shkencave Teknike Mjekësore për programin e studimit MP ne Fizioterapi, plotëson kriteret e nevojshme për sa i përket organizimit dhe strukturën akademike, por jo për titujt akademik. Përgjegjësit e programit të studimit në Departamenti I Shkencave Teknike Mjekësore nuk kanë tituj akademik Profesor apo Profesor të asociuar. Megjithatë nga analiza estafit akademik në departament, GVJ konstaton se janë 10 petagoge të brendshëm (PAE) dhe 7 te jashtëm (PAK).  <i>Ref. Dok. 121 Tabellat përmbledhëse- Tabela 1.</i>
<b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis	Njësia bazë, Departamenti i Shkencave Teknike Mjekësore, përgjegjëse për programin e studimit MP ne Fizioterapi nuk përmbush plotësisht detyrimet ligjore për nivelin e kualifikimit të personelit akademik. 60% e stafit akademik të brendshëm paraqitet pa grade shkencore, vetëm me Msc dhe vihen re mbivendosje e tyre.

personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.	<i>Ref. Dok, nr.22. Stafit akademik i Fakultetit te Shkencave Mjekesore 2020 - 2021.</i>			
<b>Kriteri 4.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	Departamenti i Shkencave Teknike Mjekesore plotëson kriteret e nevojshme për sa i përket titujve akademike dhe shkencore të drejtuesve dhe stafit përkatës. Por jo që vihet re, është moshë madhe në drejtimin e njësisë kryesore e asaj bazë dhe në ndonjë rast dhe mbivendosje të kompetencave ndërmjet njësive të ndryshme. GVJ gjykon se KUR nuk e ka arritur plotësimin e rekomandimeve 2,3 dhe 5 e dhene nga Bordi i Akreditimit ne vitin 2019 për të plotësuar këtë kriter.  <i>Ref. Dok, nr. 21 Stafit akademik i Njesise Baze 2020 – 2021.</i> <i>Ref. Dok.nr. 102-116 Cv-stafit akademik.</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike.	IAL angazhon vetëm 1-personel ndihmës në shërbim të laboratorëve e praktikave mesimore. Nga shqyrtimi i Curriculum Vitae te personelit vërehet se, personeli akademik ndihmës nuk zotërojnë të gjitha kushtet e parashikuara nga rregulloret në fuqi dhe të jenë ekspertë të fushës ku ata kontribuojne.  <i>Ref. Dok.nr. 102-116 Cv-stafit akademik</i>			
<b>Kriteri 6.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin Master Profesional ne Fizioterapi kishte caktuar një pedagog në rolin e koordinorit të programit të studimit (Vendimi Nr.2 i Rektoratit dt.13.11.2018) me të cilin GVJ u takua dhe u pergjigj vazhdimisht në kohën e vizites.  <i>Ref.Dok.nr.33. Vendim per emerimin e Kordinatorit të Programit</i>			
<b>Kriteri 7.</b> Koordinator i programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësisë përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit.	Nga dokumentacioni në dispozicion dhe intervistat e bëra gjate vizitës ne aktivitet nuk rezultonse, koordinatori i programit përgjegjës të raportoj lidhur me këtë standard.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
		X		

### Standardi II.3

**Programet e studimit të ciklit të dytë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe të organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të dytë.**

**Kriteret**

**Vlerësimi i ekspertëve**

<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Njësia kryesore dhe bazë paraqesin përgjegjësi për programin e studimit Master i Shkencore në Fizioterapi. Ato disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit. Konkretikisht fakulteti i Shkencave Mjekësore në Kolegjit Universitar "Reald", është njësia kryesore, që kryen këtë funksion, duke patur informacion për të gjitha veprimtaritë akademike në lidhje me zbatimin e planit mësimor për programin e studimi.</p> <p><i>Ref. Doc. Nr. 5 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Mjekësore Ref. Ref. Dok.nr.46 Programi Mesimor i programit MP në Fizioterapi- i riorganizuar në masën nën 20%.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p>	<p>Programi i studimit është i organizuar në lëndë/module, në të cilën përfshihet edhe praktika profesionale, në përputhje me VKM 41.</p> <p><i>Ref. Dokumenti nr.13 Rregullorja mësimore e Programit të Studimit; Dokumenti nr.46 Programi Mesimor i programit MP në Fizioterapi- i riorganizuar në masën nën 20%.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në “Fizioterapi”, zgjat 1 vit akademik, i organizuar në mësimdhënie me 60 kredite sipas sistemit vendas e atij evropian. Një vit akademik është i ndarë në 2 semestra dhe me kohë të plotë.</p> <p>Plani analitik i lëndëve është në përputhje me dispozitat ligjore, VKM 41/2018, për nga struktura, por jo nga përmbajtja e tyre.</p> <p><i>Ref. Dok.nr.18. Syllabuset Mp. Fizioterapi 2020-2021. Dokumenti nr.46 Programi Mesimor i programit MP në Fizioterapi- i riorganizuar në masën nën 20%.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në Fizioterapi ka plan mësimor, ai është organizuar në lëndë e module dhe vlerësuar në kredite. Nga analiza e Aneksit mbi Tabelat Përmbledhëse në faqen 6, rezulton se orët e parashikuara në auditore mësimore dhe jashtë nuk kuadron me totalin e oreve 1242 gjithësej si paraqitet në tabelë. Gjithashtu, orët total për leksionet janë 368 dhe për seminare 204 ndërsa në totale janë paraqitur 608. Ritheksojme se orët gjithësej për MP në me 60 ECTS duhet të jene 1500 orë, përputhje me VKM nr.41.</p> <p><i>Ref. Dok. Nr 121. Tabelat përmbledhese per Aneks_RVB - MP. Fizioterapi. Dok nr. 18 Syllabuset MP Fizioterapi 2020-2021</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe</p>	<p>Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Mjekësore përmban të gjithë informacione nevojshëm që lidhet me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit të studimeve. Në nenin 13 të Rregullores shprehet se mund të pranohen: Studentë që zotërojnë një diplomë të lëshuar nga një institucion i arsimit</p>

ekuivalentimit të studimeve.	<p>të lartë kanë mundësi të aplikojnë për tu pranuar në IAL për të ndjekur programin e studimit MP në Fizioterapi.</p> <p><i>Ref. Dok.nr.5 Rregullore e Fakultetit te Shkencave Mjekësore.</i></p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarat apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në “Fizioterapi” përmban informacionin për ngarkesën mësimore, orët në auditor dhe jashtë auditorit. Tabela përmbledhëse që ndan orët mësimore nuk është e saktë, numri i orëve të mësimin në auditor dhe jashtë nuk përkon me orët gjithësej.</p> <p>Informacioni i ofruar për programin e studimit, me lëndët përbërëse të tyre pasqyrohen në programin e lëndëve dhe syllabuset e moduleve përbërëse të tyre. Në to jepen të detajuara objektivat formuese të lëndës, konceptet themelore të saj, metodat e mesimdhënies, frekuentimi, temat e lëndës, program I lëndës forma e kontrollit të dijeve, literatura e rekomanduar nga docenti. Të gjithë komponentet formues janë në përputhje me formatet e miratuara.</p> <p>Gjatë analizës së syllabuseve u ve re se në disa lëndë të kategorise B, ngarkesa në auditor nuk i përkiste shumës së leksioneve dhe seminareve. Përmendim këtu lëndët si: Teknika e Rehabilitimit në Reumatologji, Teknikat e Rehabilitimit Special etj.</p> <p>Gjithshtu në Planin Mësimor lënda e kategorisë C, Menaxhim i pacientit kritik/Menaxhimi i pacientit gjatë fatkeqësive, paraqitet me 3 ECTS, ndërsa në syllabuse paraqitet e ndarë në 2 module me 3 ECTS secili modul (pra 3 kredite më shumë) me ngarkesë 72 orë (36+36 për secilin modul).</p> <p><i>Ref. Dok.nr.46 Programi Mesimor i programit MP ne Fizioterapi- i riorganizuar në masën nën 20%.</i></p> <p><i>Ref. Dok.nr.5 Rregullore e Fakultetit te Shkencave Mjekësore.</i></p> <p><i>Ref. Dok. Nr 121.Tabelat permbledhese per Aneks_RVB - MP. Fizioterapi.</i></p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Nga dokumentacioni në dispozicion dhe intervistat e bëra gjatë vizitës në aktivitet u vërtetua se programi i studimit 2020-2021 është përmirësuar dhe përditësuar pjesërisht krahasim me atë të vitit akademik 2019-2020 dhe është miratuar nga Senati Akademik me vendim nr. 36 datë 01.06.2020 dhe më pas aprovuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.</p> <p><i>Ref. Dok.nr.46 Programi Mesimor i programit MP ne Fizioterapi- i riorganizuar në masën nën 20%.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>



**Standardi II.4**

**Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p>Nga dokumentacioni në dispozicion rezulton se janë të ndara nëpërputhje me VKM nr.41, numri i ECTS dhe ngarkesa e orëve për praktikat profesionale.</p> <p>Në tabelën e kategorizimit të lëndëve, praktika profesionale paraqitet me 6 ECTS, ndërsa në planin mësimor të detajuar paraqitet me 72 orë në auditor, 36 orë seminare dhe 36 orë jashtë auditorit. Praktika profesionale nuk mund të paraqitet e ndarë në këtë mënyrë, gjithashtu nuk respektohet shuma 150 orë për 6 ECTS (25 orë për 1 ECTS). Gjithashtu GVJ konstaton se orët gjithësej të paraqitura në planin mësimor nuk janë në përputhje me VKM nr 41, 60 ECTS duhet të kishin një ngarkese totale prej 1500 orë dhe jo 1262 sic është paraqitur në planin mësimor të riorganizuar, <i>GVJ konstaton se ka një problematikë në ndarjen e krediteve dhe të orëve mësimore, brenda dhe jashtë auditorit dhe I rekomandon IAL-së të realizoj ndryshimet e duhura.</i></p> <p><i>Ref. Dok. Nr 121. Tabelat përmbledhese për Aneks_RVB - MP. Fizioterapi</i></p> <p><i>Ref. Dok. nr. 44 Programi mesimor i programit MP në Fizioterapi i riorganizuar në masën nën 20%.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë thellim të njohurive dhe aftësive dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Bazuar në planin mësimor GVJ konstaton se përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, nuk mundësojnë plotësisht thellim të njohurive dhe aftësive profesionale. Institucioni paraqet një plan studimi Master Profesional në "Fizioterapi" të përgjithshëm dhe jo të profilizuar.</p> <p><i>Ref. Dok.nr.46 Programi Mesimor i programit MP në Fizioterapi- i riorganizuar në masën nën 20%.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.</p>	<p>Organizimi i programit Master Profesional në Fizioterapi në Kolegjin Universitar Reald, mundëson kryesisht arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të pritshme të të nxënit që synon ky institucion. Programi është i shpërndarë në 1- vit studimi me 2-semestra dhe në total ka 60 kredite.</p> <p>Programi mësimor është hartuar dhe emërtuar në mënyrë të tillë që u shërben studentëve për të marrë dije profesionale teorike dhe praktike në fushën e fizioterapisë.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori/praktikë është në përputhje</p>	<p><i>Ref. Dok.nr.46 Programi Mesimor i programit MP në Fizioterapi- i</i></p>



Adresa: "Rruga e Durrësit", nr. 219, Tiranë

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 25

me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	<i>riorganizuar në masën nën 20%.</i> <i>Ref. Dok. Nr 121. Tabelat përmbledhese për Aneks_RVB - MP. Fizioterapi</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Raporti midis formimit teorik dhe praktik është shprehur në program sipas VKM nr 41. Veprimtaritë formuese ndahen respektivisht në 6 ECTS (10% e programit të studimit) në atë praktik, 9 ECTS (15% e programit) për detyrimin përfundimtar dhe në 45 ECTS për formimin teorik (75% e programit).  <i>Ref. Dok.nr.46 Programi Mesimor i programit MP në Fizioterapi- i riorganizuar në masën nën 20%.</i>			
<b>Kriteri 6.</b> Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.	Nga analiza e syllabuseve të vena në dispozicion u vënë re se, literatura e pasqyruar në toparaqitet shumë e vjetëruar (jo recente). Ajo nuk është azhurnuar dhe verëhet mungesa e literaturës së huaj bashkëkohore.  <i>Ref. dok.nr.19 19. Syllabuset Mp. Fizioterapi 2020-2021. Dok nr. 18 Syllabuset MP Fizioterapi 2020-2021</i>			
<b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të dytë.	Programi i studimit Master Profesional në Fizioterapi garanton pjesërisht përfitimin e dijeve në fushën e rehabilitimit. Megjithatë ai synon të pajis studentët me njohuri dhe shprehje komplementare, që do të shërbejnë atyre në punësim.  <i>Ref. Dok.nr.46 Programi Mesimor i programit MP në Fizioterapi- i riorganizuar në masën nën 20%.</i>			
<b>Kriteri 8.</b> Organizimi i programit të studimit siguron aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.	Programi i studimit është hartuar duke pasur në konsideratë zhvillimin ekonomik dhe perspektivën e tregut të punës në Shqipëri dhe në Rajonin e Jugut. Përmbajtja e programit të studimit u mundëson studenteve thellim të njohurive duke i garantuar atyre mundësi në ndjekjen e studimeve më të larta.  <i>Ref. Dok.nr.46 Programi Mesimor i programit MP në Fizioterapi- i riorganizuar në masën nën 20%.</i>			
<b>Kriteri 9.</b> Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut të punës.	Përmbajtja e programeve të studimit mundëson punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut të punës në vendin tonë.  <i>Ref. Dok.nr. 28 Te dhena mbi punësimin e studentëve të diplomuar 2016-2019.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
		X		

**Standardi II.5**

**Personeli akademik dhe ndihmës-akademik, që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik dhe profesional për garantimin e standardeve të mësimdhënies në kuadër të programit të studimit.**

**Kriteret****Vlerësimi i ekspertëve**

**Kriteri 1.** Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.

Nga dokumentacioni në dispozicion rezultojnë se staf PAE me MP/Msc, të cilët ishin edhe titullarëtë disa lëndëve në mënyrë të përsëritur, duke mos përmbushur kërkesat sipas Ligjit 80/2015, të Arsimit të Lartë të Shqipërisë. Ndarja e personelit me kohë të plotë dhe të pjesshëm në 3-vitet e fundit rezultojnë si më poshtë:

Stafi akademik i programit MP ne "Fizioterapi"	Viti akademik 2020-2021		Viti akademik 2019-2020		Viti akademik 2018-2019	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
	Prof Dr	-	-	-	-	-
Prof.Assoc	-	-	1	-	2	
Dr/PhD	3	1	3	1	2	
Msc	1	2	2	3	4	1
MP	1	-	1	-	1	
<b>TOTAL</b>	<b>5</b>	<b>3</b>	<b>7</b>	<b>4</b>	<b>9</b>	<b>1</b>

*Ref. Dok.nr.46 Programi Mesimor i programit MP ne Fizioterapi- i riorganizuar në masën nën 20%.*

*Ref. Dok. 121 Tabellat permbledhese, Tab nr. 12.1, 12.2 dhe 12.3*

**Kriteri 2.** Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.

Personeli akademik për vitin 2020-2021, si PAK edhe PAE rezultojnë pa titujt e nevojshëm. Bazuar në numrin e orëve raporti është 408 orë PAE dhe 180 orë PAK me raportin 69.4% dhe 30.6%

Ndarja e tyre sipas titujve është si më poshtë:

PAE: 5 lektor (3 Dr., 1 Msc.1 MP) dhe PAK 3 lektor (1 Prof. Dr., 2 Dr., 4 Msc.).

Për vitin akademik 2019-2020 stafi akademik ka pasur kualifikimin si vijon:

PAE: 7 lektor (1. Prof As. 3 Dr., 2 Msc.1 MP) dhe PAK 4 lektor (1 Dr., 3 Msc.).

Për vitin akademik 2018-2019 stafi akademik ka pasur kualifikimin si vijon:

PAE: 9 lektor (2. Prof As. 2 Dr., 4 Msc.1 MP) dhe PAK 1 lektor 1 Msc.).

Po ti referohemi ngarkësës dhe kriterit ligjot për mbulimin e ngarkësës mësimore 70% nga PAE, shohim që për vitin 2020 -2020, ky kriter është pothuajse i përmbushur. Ajo që bie në sy është që në këtë program janë

	<p>të angazhuar në mësimdhënie staf pa tituj dhe grada.</p> <p>GVJ konstaton se ngarkesa mësimore nuk është bazuar në Udhëzimin Nr. 29, datë 10/09/2018 “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në IAL”.</p> <p>Vërehet nga evidence nr. 98, një shpërndarje e ngarkesës mësimore në mënyrë propocionale të stafit akademik në diplomën Master Profesional në “Fizioterapi”, por vërehet se të njëjtët pedagogë japin mësim dhe në programe të tjera dhe ngarkesa vjetore është e madhe.</p> <p>Në evidencën nr 121 GVJ vëre shpërndarjen e ngarkesës mësimore për vitin akademik 2020-2021, ku vrehet një shpërndarje e ngarkesës e përmirësuar në krahasim me vitet e mëparshme, por në këtë program studimi stafi i angazhuar është më Master Profesional.</p> <p><i>Ref.Dok.nr.22 Staf i akademik i Fakultetit te Shkencave Mjekesore 2020 - 2021.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e antarëve të personelit akademik, kualifikimet e tyre akademike dhe ekspriencia e gjatë në mësimdhënie, që mbulon programin e studimit, nuk është në përputhje të plotë me natyrën dhe specifikën e moduleve të programin e studimit, ku janë të përfshirë në mësimdhënie.</p> <p><i>Ref. dok.nr.19 19. Syllabuset Mp. Fizioterapi 2020-2021.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për udhëzimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>IAL paraqet bashkëpunime modeste me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, në dispozicion të studentëve dhe stafit akademik. Nga evidencat e vëna në dispozicion si dhe vizita pranë KUR, GVJ nuk konstatoj asnjë raport mbi efikasitetin e këtyre marrëveshjeve. Nuk u gjend asnjë raport mbi një tutorim efikas dhe mbikëqyrje të vazhdueshme të mbarvajtjes së studentëve gjatë praktikave profesionale, duke qënë se në këtë program ka pasur vetëm një student</p> <p><i>Ref.Dok. 31 Marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet per kryerjen e praktikave mesimore</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni i arsimit të lartë siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësmësimor-shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>IAL paraqet vetëm 1-personel ndihmës funksional, në shërbim të laboratorëve e praktikave. Laboratorët e IAL janë në dispozicion të stafit akademik dhe studentëve janë modeste për realizimin e procesit mësimor.</p> <p><i>Ref.Dok. Nr 121.Tabelat permbledhese per Aneks_RVB - MP. Fizioterapi</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

### Standardi II.6

**Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit dhe realizimin me sukses të tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	Nga dokumentacioni në dispozicion nuk rezulton se strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.  <i>Ref.Dok. 31 Marreveshjet e bashkepunimit me institucionet per kryerjen e praktikave mesimore</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime, në kuadër të përmirësimit të programit të studimit, edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit.	Gjatë vizites ne ambientet e IAL, GVJ nuk iu mundesua asnjë takim me studentët, për vërtetimin e përfshirjes së tyre në diskutime, në kuadër të përmirësimit të programit të studimit.  <i>Ref. Vizita në Institucion.</i>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programeve të studimit.	Mungesa e komunikimit me studentet apo me stafin akademik, nuk na lejoji të vërtetohet arritjen e këtij standardit nga IAL për programin e studimit.  <i>Ref. Vizita në Institucion.</i>
<b>Kriteri 4.</b> Në bashkëpunim me institucionet publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme në përputhje me kërkesa dhe nevoja specifike lokale dhe zhvillimi.	Nuk u evidentuar asnjë document justifikues ku të tregohet se si pasojë e bashkëpunimeve me institucione publike e private IAL përditëson dhe riorganizon programe specifike për nevojat lokale.  <i>Ref. Vizita në Institucion.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<b>Standardi III.1</b>	
<b>Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>KU Reald ka hartuar dhe rishikuar rregulloret për funksionimin e institucionit sipas rekomandimeve të Bordit të akreditimit në akreditimin e fundit, të miratuara nga Senati Akademik me vendim Nr.33, datë 22.04.2020.</p> <p>Rregullorja e programit të studimit përcakton elementët e mësimdhënies në programin e studimit, procesin e vlerësimit dhe testimit të njohurive</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>IAL ka ngritur NJSBC, e cila sipas rregullores së miratuar merret me monitorimin e procesit mësimor, aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik. Kjo strukture nëpërmjet intervistave e anketimeve jep kontributin e saj në raportimet vjetore të IAL.</p> <p><i>Ref. Dok. Nr.23Te dhena mbi perberjen e NJSBC - Vendim nr. 1 dt.18.10.2019 - Miratim strukture NJSBC dhe ZBNJ.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>IAL përfshin studentët në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve dhe nga strukturat përkatëse është përfshirë mundësia e trajtimit të ankimimeve, si e drejte e studentëve dhe në shërbim të përmirësimit të procesit për realizimin e programit. Në cdo vendimarrje janë përfshire edhe studentët duke dhene kontributin e tyre më përfshirje në Senat dhe ne NJSBC.</p> <p><i>Ref. Dok. Nr 2 Statuti i Kolegjit Universitar REALD</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Rezultatet e vlerësimit të pedagoqeve bëhen publike nga strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie. Studentëve vazhdimisht gjatë vitit akademik u prezantohen pyetësor për studimet e vlerësimeve. Nëpërmjet NSBC-së raporti i rezultateve të vlerësimit publikohet në ëeb-in e institucionit.</p> <p><i>Ref. Dok. Nr. 8 Pyetësor per studentin - Formular vleresimi aktiviteti - NJSBC</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Institucioni, nëpërmjet metodës të vlerësimit dhe rezultateve të marra, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. Pjesë e këtij procesi është edhe Formulari i vetëvlerësimit të performancës së personelit akademik.</p> <p><i>Ref. Dok. Nr. 89 Formular vetevleresimi i pedagogut 2019 - 2020.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X


### Standardi III.2

**Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë: leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Format e mësimdhënies në programin e studimit Mater Profesional në Fizioterapi janë leksionet, seminarët, labororet, praktika, detyrat e kursit etj. Studentët gjithashtu marrin pjesë në konferenca shkencore edhe pse janë shumë të ralla në IAL.</p> <p><i>Ref. Dok.nr.19 Syllabuset Mp. Fizoterapi 2020-2021. Dok. Nr.44 Plani Mesimor.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.</p>	<p>Personeli akademik në IAL përpiqet për të ofruar forma, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit MP në Fizioterapi në përgjithësi dhe specifikisht për module të vecanta gjithashtu është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij. GVJ mësoi këtu për mësimdhënien <i>online</i>.</p> <p><i>Ref. Dok. Nr. 80. Google Classroom Manual pedagogu.</i> <i>Dok. Nr.81. Manual për programin OBS për regjistrim Video dhe audio.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni duhet të mundësojë përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>GVJ nuk iu prezantua një menyrë që IAL të mundësojë përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p> <p>Gjate vizitës në ambientet e IAL u përmend vetëm mësimdhënien <i>online</i> si metodë fleksible pedagogjike.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Nga informacioni i vënë në dispozicion nga Institucioni dhe vizita në ambientet e tij u vë re se, personeli akademik është i ri në fushë dhe pa titujt e nevojshëm, për të gëzuar njohuritë dhe konceptet e duhura në mësimdhënien e programit MP.</p> <p><i>Ref. Dok. Nr.102-1016Curriculum vitae personelit akademik</i></p>

<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Bazuar në eksperiencën e fituar gjatë programit Bachelor në Fizioterapi, IAL ka një vlerësim për përmirësimin e formave e metodave të mësimdhënies dhe ka përfshirë edhe studentin e vetëm të regjistruar në këtë proces për një përmirësim të programit MP në Fizioterapi.</p> <p><i>Ref. Dok. Nr. 87 Pyetesor per studentin-Formular vleresimi aktiviteti - NJSBC</i></p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimi.</p>	<p>Institucioni ka vënë në dispozicion të stafit akademik dhe studentëve të gjithë logjistikën e nevojshme për realizimin e programit mësimor si laboratorët mësimorë, kompjutera, sisteme projektivi, ekrane mësimore, tabela shkrimi, internet etj.</p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Të gjitha këto mundësojë përdorimin e metodave të shumëllojshme, inovative dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënësve, objektivat formuese që ka programi i studimit.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p><b>Standardi III.3</b>  <b>Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Procesi mësimor e shkencor, realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p>	<p>Hapësirat për realizimin e procesit mësimor janë të mjaftueshme. Ato janë të pajisura me teknologji, mjete e orësi modeste. Të tilla janë sallat dhe auditoret e leksioneve, seminareve, laboratorët/kabinetet. Laboratori i Fizioterapisë është i pajisur me pajisje modeste.</p> <p><i>Ref. Dok. Nr. 78 Laboratorët në IAL</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor dhe praktikave.</p>	<p>Nga vizita në Institucion rezultoi se, ambientet e vëna në dispozicion për procesin mësimor janë të bollshme, funksionale dhe të pajisura me mjete e teknologjinë modeste për realizimin e procesit mësimor dhe praktikave.</p> <p><i>Ref. Vizita në IAL</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor.</p>	<p>IAL ka instaluar në salla, auditore e mjedise të tjera teknologjinë e nevojshme informatike dhe personeli akademik e studentët shfrytëzojnë këtë infrastrukturë informatike të nevojshme për realizimin e procesit mësimor. Procesi mësimor i informatikës zhvillohet në sallën e IT.</p>



	<i>Ref. Vizita në IAL</i>
<b>Kriteri 4.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	<p>Studentet sigurojnë nga stafi akademik literature bazë jo të përditësuar. Nga analiza e syllabuseve rezultojnë literature e sugjeruar nga titullarët e moduleve jo bashkëkohore dhe kryesisht në gjuhën shqipe.</p> <p>Bibloteka e IAL paraqitet me numër shumë të vogël literaturë, kryesisht shqip. Shtimi i literaturave në bibliotekën e IAL gjatë vitit 2020 rezultoi i ulët dhe vihet re mungesë e librave të huaj. <i>GVJ sugjeron përditësim të literaturave me tekste bazë dhe ndihmëse.</i></p> <p><i>Ref. Dok. Nr. 55 Shkresë nr. 89 date 15.06.2020 - për pasurimin e Bibliotekës me libra të rinj.</i></p>
<b>Kriteri 5.</b> Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.	<p>Bibloteka e IAL paraqitet me ambient të thjeshtë dhe jo shumë e pasur me libra në fushën e Shkencave Mjekësore. Në të kryeson literature shqiptare, dhe jo e 5-viteve të fundit.</p> <p>Në listën e librave shtesë gjatë vitit 2020 në Bibliotekën e IAL rezultojnë vetëm 14 libra në fushën e Shkencave Mjekësore. Në dokumentin justifikues nuk janë shprehur fare vitet e botimit të librave shtesë.</p> <p><i>Ref. Dok. Nr. 55 Shkresë nr. 89 date 15.06.2020 - për pasurimin e Bibliotekës me libra të rinj.</i></p>
<b>Kriteri 6.</b> Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.	<p>Literatura specifike për Fizioterapi është shumë e ulët në Bibliotekën e Kolegjit Universitar Reald. Gjatë vizitës në aktivitetet nuk vertetohet asnjë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>
<b>Kriteri 7.</b> Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.	<p>Në ambientet e IAL janë në dispozicion për studentët laboratore të thjeshtë, për realizimin e projekteve apo kërkimeve të ndryshme detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike. Theksojmë se në vitin e fundit ka qenë diplomuar vetëm një student në programin e studimit MP në Fizioterapi.</p> <p><i>Ref. Dok. Nr. 78 Laboratorët në IAL</i></p>
<b>Kriteri 8.</b> Në funksion të mësimdhënies, personelin akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	<p>Ky kriter gjeti një zbatim absolut në Pandemi duke patur një pjesëmarrje dhe angazhim të plotë nga të dy palët, stafit akademik dhe studentëve.</p> <p>Gjatë vitit akademik 2020-2021 personeli akademik dhe student i vetëm i diplomuar në programin MP, përdoren platforma on-line/e-learning (si Google Classroom) për leksionet, testimet e njohurive dhe praktikat mësimore.</p>

	<i>Ref. Dok. Nr. 79 Google Classroom Manuali student.</i>			
<b>Kriteri 9.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.	Lektorët dhe studentët nuk kanë hapsirat e tyre në sistemin informatik të IAL dhe nuk e shfrytëzojnë këtë sistem komunikimi për nevoja të ndryshme gjatë vitit akademik. Kryesisht operohet me leksionet e përgatitura nga personeli akademik.			
	<i>Ref. dok. nr.19. Syllabuset Mp. Fizioterapi 2020-2021</i>			
<b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.	Personeli përgatit studentet për diplomim dhe orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin dhe prezantimin e tyre. Institucioni ka një rregullore për procedure e zgjedhjes dhe miratimit të temës së diplomës dhe vleresimin e saj.			
	<i>Ref. Dok. Nr.10 Rregullore e Diplomimit.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

#### Standardi III.4

**Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë, aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.	IAL ka organizuar strukturat të tilla si: kordinatori i programeve, zyra e karrierës, duke synuar që nëpërmjet tyre të promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë, me njësitë kryesore/bazë, aktivitetet për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. IAL ka ngritur NJSBC, e cila sipas rregullores së miratuar merret me monitorimin e procesit mësimor, aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik. GVJ gjykon se këto përpjekje nuk kanë cuan në rritjen e cilësisë së mësimdhënies për programin e studimit MP në Fizioterapi. Nga analiza e kualifikimeve të stafit akademik, vihet re mungesë e gradave dhe titujve të nevojshme për zhvillimin e mësimdhënies sipas legjislacionit.  <i>Ref. Dok. Nr.5 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Mjekësore</i>
<b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes të personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.	Në Kolegjin Universitar REALD njësia kryesor Fakulteti i Shkencave Mjekësore dhe departamentet e tij, janë përgjegjëse për sigurimin e cilësisë së mësimdhënies dhe ndërgjegjesimin e personeli akademik dhe studentëve për cilësinë në programet e studimit.  <i>Ref.Dok. Nr.5 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Mjekësore</i>
<b>Kriteri 3.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin	IAL shfaq interes, nëpërmjet strukturave dhe njësive përgjegjëse të mbështetesi eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative

<p>eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>të mësimdhënies nepermjet propozimeve mbi bazën e nevojave që kanë, në organet drejtuese.</p> <p><i>Ref. Dok. Nr. 90 Raport vjetor i NJSBC 2019-2020.</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Personeli akademik dhe ai mbështetës e ka të nevojshme kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor, për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. Nuk u evidentuar asnjë kualifikim i stafit të këtij programi studimi i realizuar këto kohët e fundit.</p> <p><i>Ref. Nr. 121 Tabelat permbledhese per Aneks_RVB - MP. Fizioterapi.</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>Gjatë takimeve të realizuara ne KU Reald na u tha se në kuadër të rritjes së cilësisë së mësimdhënies shërbejnë dhe leksionet e hapura të organizuara nga departamentet në ditë të veçanta kombëtare të lidhura me shëndetin si dita e diabetit, hipertensionit, dhurimit të gjakut, talasemisë, etj. Në këtë ditë krahas pedagogëve paraqiten dhe punë të kryera nga studentët apo referime të përgatitura prej tyre.</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>Personeli akademik dhe personeli ndihmës janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimit. Dekani i Fakultetit të Shkencave Mjeksore në cilësinë e përgjegjësit për programin e studimit dhe kordinatori i programit vazhdimisht përipiqen të përmirësojnë cilësinë e mësimdhënies.</p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p><i>Ref. Dok. Nr. 90 Raport vjetor i NJSBC 2019-2020.</i></p>			
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Nga dokumentacioni në dispozicion nuk u gjetë asnje bashkepunim për përfshirje të partnerëve në procesin mësimor dhe të angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit, lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

**Standardi III.5****Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>			
<b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Bazuar ne Rregulloren e institucionit dhe syllabuseve, janë të përcaktuara qartë kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale. Këto rregullore janë publike dhe gjenden edhe online në faqen elektronike të IAL-së.  <i>Ref. Dok. Nr. 4 Rregullore e pergjithshme e IAL.</i> <i>Ref. Dok. Nr. 19 Syllabuset Mp. Fizioterapi 2020-2021</i>			
<b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Ne Rregullore e Përgjithëshmetë Kolegjit Universitar Realdështë paraqitur se, personeli akademik në fillim të çdo lënde informon studentët me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve.  <i>Ref. Dok. Nr. 4 Rregullore e pergjithshme e IAL.</i> <i>Ref. Dok. Nr. 19 Syllabuset Mp. Fizioterapi 2020-2021</i>			
<b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore i studentëve realizohet sic është parashikuar në rregullore e syllabuse. GVJ gjykon se ka rëndësi edhe komunikimi i drejtëpërdrejtë gjatë procesit mësimor që është efikas. Numri i ulet i studentëve e mundeson kete gjë.  <i>Dok. Nr. 19 Syllabuset Mp. Fizioterapi 2020-2021</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

**Standardi III.6****Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.	Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore i studentëve realizohet sic është parashikuar në rregullore e syllable, gjate gjithë vitit akademik. Procedura është pasqyruar ne Rregulloren e programit Mp në Fizioterapi. Format dhe kriteret e vlerësimit të studentit përcaktohen në planin mësimor, në programin e lëndës dhe i bëhen të ditura studentëve. Ato te detajuara paraqiten ne Syllabuse. Aty rezulton se: Vlerësimi i vazhduar 40% (aktivizimi 10%, Provimi i ndërmjetëm 30%) Provimi përfundimtar 60 %.  <i>Dok. Nr. 19 Syllabuset Mp. Fizioterapi 2020-2021</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të	Institucioni nuk vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe

testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën. Ritheksojme se, programi i studimit ka vetëm 1-student të regjistruar për praktikuar te tilla testime.  <i>Dok. Nr. 19 Syllabuset Mp. Fizoterapi 2020-2021</i>
<b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi përfundimtar i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.	Bazuar në Rregulloren e Fakultetit të Shkencave Mjekësore, testimi e vlerësimi përfundimtar i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë. Titullari i lëndës është anëtar i komisionit të provimeve dhe asistenti i tij.  <i>Ref. Dok. Nr5. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Mjekësore.</i>
<b>Kriteri 4.</b> Testimi i vlerësimit të njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.	Gjatë vitit akademik 2020-2021 në programin mësimor ishte regjistruar 6 studentë, nga të cilët vetëm 1 është diplomuar, pasi të tjerët janë çrregjistruar. Për rrjedhojë testimi i vlerësimit të njohurive në mënyrë anonime nuk praktikohet. Kalueshmeria e një moduli është 100% kur student merr vlerësim pozitivë dhe 0% kur nuk e kalon atë duke qënë se kemi vetëm një student.  <i>Ref. Dok. Nr5. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Mjekësore.</i>
<b>Kriteri 5.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Komisionit të Provimit i kërkohet t'i shpjegojë studentit vlerësimin e bërë dhe nëse provimi është në formë të shkruar, të ballafaqojë përgjigjet e studentit me tezën e zgjidhur, duke e ndihmuar të përmirësohet në të ardhmen.  <i>Ref. Dok. Nr5. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Mjekësore.</i>
<b>Kriteri 6.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar për këtë proces vlerësimi dhe vizitën në institucion, GVJ konstatoi se KU Reald nuk kishte një sistem antiplagjiaturë, në të cilin të bëheshin kontrollat për temat e diplomave apo detyrat e kursit që kishin studentët.
<b>Kriteri 7.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Bazuar në Rregulloren e IAL në nenin 58 përcaktohen modalitetet e vlerësimeve. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse. Pas përfundimit të çdo provimi apo formave të tjera të kontrollit të dijeve, rezultatet bëhen të njohura brenda 3 ditëve nga dita e zhvillimit të tij. Një ditë pas shpalljes së rezultateve, pranohen dhe vlerësohen ankesat e studentëve.  <i>Ref. Dok. Nr 4 Rregullore e përgjithshme e IAL.</i>
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe	Studentët kanë të garantuara nga Kolegji Universitar Reald, të drejtat për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. Studentët kanë të drejtë të shikojnë personalisht provimin në prezencë

procedurat e vlerësimit.	të pedagogut të lëndës, për të marrë sqarimet e duhura. Për sqarime të mëtejshme ata kanë të drejtë t'i drejtohen me shkrim Dekanit të Fakultetit.  <i>Ref. Dok. Nr 4 Rregullore e përgjithshme e IAL</i>								
<b>Kriteri 9.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.	Ankimimin për rezultaten përfundimtar të provimit. Sipas Nenit 59 të Rregullores Ankesa i paraqitet me shkrim përgjegjësit të departamentit brenda 24 orëve. Dekani, brenda 24 orësh nga marrja dijeni për ankesën nga përgjegjësi i departamentit, ngre një komision <i>ad-hoc</i> i cili bën verifikimin e pretendimeve të studentit. Me miratim të dekanit komisioni përcakton vlerësimin përfundimtar të provimit.  <i>Ref. Dok. Nr 4 Rregullore e përgjithshme e IAL</i>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td>X</td> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht		X		
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
	X								

<b>Standardi III.7</b>	
<b>Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Nga analiza e dokumentacionit në dispozicion, programi i studimit është i organizuar në lëndë/module dhe praktika. Përmbajtja e tyre dhe metodat e mësimdhënies krijojnë mundësinë dhe nuk garantojnë plotësisht thellimin e njohurive, zhvillimin e aftësive profesionale dhe të veçanta të studentëve.  <i>Ref. Dok.46 Programi Mesimor i programit MP ne Fizioterapi- i riorganizuar në masën nën 20%.</i>
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, të komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Programi i studimit ndihmon përgatitjen e studentëve me njohuri, aftësi e kompetenca të nevojshme profesionale teorike dhe praktike për realizimin e misionit të fizioterapistit si dhe pajisjen e tyre me njohuri në fusha të veçanta të komunikimit dhe ndërveprimit.  <i>Ref. Dok.46 Programi Mesimor i programit MP ne Fizioterapi- i riorganizuar në masën nën 20%.</i>
<b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.	Nga analiza e syllabuseve vihet re përpjekje për përgatitjen e studentëve me aftësitë dhe kompetencat e paraqitura në programin e studimit. GVJ gjykon se, nevojiten module me të profilizuara dhe literature më recente nga sugjerimet e titullareve të çdo moduli.  <i>Ref.Dok. Nr. 19 Syllabuset Mp. Fizoterapi 2020-2021</i>
<b>Kriteri 4.</b> Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli	

akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.									
<b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.									
<b>Kriteri 6.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.	Në përmbajtjen e Planit Mësimor i është dhënë vëmendje e vecante laboratorëve dhe praktikave profesionale. Praktikant zënë rreth 33% të peshës së mësimdhënies vjetore.  <i>Ref. Dok. Nr 12 Plani Mesimore 2019-2020</i>								
<b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.	Nga dokumentacioni shqyrtues vihet re se personeli akademik shpreh disponibilitet për mbështetjen e studentëve për problemet e mbarvajtjes së studimeve. Keto janë detyrim e përgjegjesi që u ngarkon rregullorja e Institucionit. Megjithatë gjate vizitës kjo gjë nuk u vërtetua, sipasojë e pamundesit të zhvillimit të intervistave me studentet.  <i>Ref. Dok. Nr 4 Rregullore e pergjithshme e IAL</i>								
<b>Kriteri 8.</b> Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe e mbështet.	Nuk u mundësua asnjë intervistë me personelin akademik dhe ate ndihmes për të vërtetuar klimën e përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore.								
<b>Kriteri 9.</b> Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	Misioni i Kolegjit Universitar Reald, është të mbështesë zhvillimin e ideve novatore, kërkimeve të avancuara dhe të studimeve shkencore, në të cilat përfshijnë edhe studentët. Edhe pse fondet për studimet e avancuara në kërkimet rezultuan modeste.  <i>Ref.Dok.2 Statuti i Kolegjit Universitar REALD</i>								
<b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Personeli akademik nuk krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore për të mundësuar stimulimin e mobilitetit të studenteve. IAL nuk bene pjese ne asnje program europian lidhur me mobilitetin e studentëve apo të stafit akademik. Nga analiza e syllabuseve nuk u evidentua asnje forem për rritjet e mobilitetit te studenteve.  <i>Ref. Dok. Nr 57 Strategji zhvillimi 2021-2026,</i> <i>Ref Dok. Nr. 19 Syllabuset Mp. Fizoterapi 2020-2021</i>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet plotësisht</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td>X</td> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht		X		
Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
	X								

<b>Standardi III.8</b>				
<b>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.</b>				
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>			
<b>Kriteri 1.</b> Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfutimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Ambientet dhe paisjet për realizimin e praktikave mësimore brenda në Kolegjit, nuk ishin bashkohore për zhvillimin e mirëfilltë të tyre. Megjithatë Kolegji bashkëpunon me spitalin e Vlorës dhe Klinikën Fizio Life, të cilët garantojnë mjedise të përshtatshme për realizimin e praktikave profesionale.  <i>Ref. Dok. Nr 29 Marreveshjet e bashkëpunimit me institucionet për kryerjen e praktikave mesimore.</i>			
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin sa më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	Institucioni paraqet marrëveshje të nënshkruara e të dokumentuara, të lidhur me Institucionet private apo publike ku zhvillon praktikat mesimore. Mund të përmendim klinikën Fizio Lifer dhe Spitalin Rajonal Vlorë për kryerjen e praktikave mësimore. <i>Ref. Dok. Nr 29 Marreveshjet e bashkëpunimit me institucionet për kryerjen e praktikave mesimore.</i>			
<b>Kriteri 3.</b> Praktikat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	Praktikat mësimore kane 6 kredite në planin mesimor dhe zgjasin 72 ore. Ato vlerësohen me notë. Gjatë vizitës në ambientet e KU Reald nuk na u paraqit asnjë material i vecantë me mendimin e trajnuesëve dhe vlerësimin përkatës për praktikat.  <i>Ref. Dok.46 Programi Mesimor i programit MP ne Fizioterapi- i riorganizuar në masën nën 20%.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Standardi III.9</b>				
<b>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.</b>				
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>			
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Institucioni paraqet një procedurë të qartë të miratuar për provimin final dhe diplomimin studentëve. Kjo procedurë është publike dhe gjendet në faqen elektronike të IAL. Ajo është pasqyruar edhe në rregulloren e përgjithëshme. Studenti lejohet të hyjë në mbrojtjen e diplomës, pasi ka fituar të gjitha kreditet e parashikuara në programin mësimor. Kërkesat e diplomimit janë paraqitur në kurrikulat e çdo programi studimi. Sekretaria mësimore i përcjellë me shkresë të veçantë përgjegjësit të departamentit dhe dekanit të fakultetit listën e studentëve që kanë			



	<p>plotësuar detyrimet e programit të studimit. Përgjegjësi i departamentit pas marrjes së listës së studentëve ngre një komision <i>ad hoc</i>, i cili verifikon nëse studentë kanë plotësuar detyrimet e programit të studimit. Pas verifikimit lista e studentëve, që kanë të drejtën e mbrojtjes së tezës së diplomës, i përcillet përgjegjësit të departamentit. Për fitimin e diplomave të ciklit të dytë të studimeve parashikohet përgatitja e një teze diplome, të përpunuar në mënyrë krijuese e të pavarur nga studenti. Drejtuesit e temave të diplomës propozohen nga departamenti me miratimin e Rektorit.</p> <p><i>Ref. Dok. Nr 4 Rregullore e përgjithshme e IAL.</i> <i>Ref. Dok. Nr 9 Rregullore e Diplomimit.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p>	<p>Udhëheqesit për provën finale zgjidhen nga vetë studentet dhe miratohen nga strukturat përgjegjëse. Në fund të vitit, studenteve u mundësohen nga Institucioni, konsulenca dhe suporti i duhur për të realizuar kërkimin shkencor sa I takon provimit final. Provimi final ka 9 kredite në planin mësimor.</p> <p><i>Ref. Dok. Nr 4 Rregullore e përgjithshme e IAL</i> <i>Ref. Dok.46 Programi Mesimor i programit MP ne Fizioterapi- i riorganizuar në masën nën 20%.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>KU Reald ka ngritur një juri të posaçme për provimin final në diplomën e studentëve. Juria dhe kryetari i saj miratohet nga dekani i fakultetit me propozim të përgjegjësit të departamentit dhe përbëhet nga 5 vetë. Në përfundim juria bazuar në vlerësimin e udhëheqesit të tezës dhe rezultatet e arritura të studentit përfshirë të gjitha lëndët, bën vlerësimin me note.</p> <p><i>Ref. Dok. Nr 9 Rregullore e Diplomimit.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të studimit/diplomave.</p>	<p>Personeli akademik në Kolegjin Universitar Reald, orientojnë dhe ndihmojnë studentët duke i fokusuar studentet për kërkimin dhe siguruar informacione dhe materiale të nevojshme për provën finale.</p> <p><i>Ref. Dok. Nr 4 Rregullore e përgjithshme e IAL</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Institucioni përcakton një stafit akademik ndihmës, i cili ndihmon dhe orienton studentët për kryerjen e testimit të kualifikimit profesional.</p> <p><i>Ref. Dok. Nr 4 Rregullore e përgjithshme e IAL</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas</p>	<p>Procedura e provimit final ne fund të MP, ndiqet nga relatori udhëheqës i temës, i cili asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar nga rregulloret e Institucionit.</p>

udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	<i>Ref. Dok. Nr 4 Rregullore e pergjithshme e IAL</i>			
<b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Studenti vlerësohet me notë në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës. Sipas rregullores neni 64, ngrihet një komisionin i cili dëgjon studentin dhe për të marrë vendimin e notës bazohet në 2 komponentë, e para në notën e vendosur nga udhëheqësi i tij dhe e dyta nga referimi i studentit. Ndërsa në Rregulloren e përgjithshme të IAL, në nenin 59 paraqitet e gjithë proceduara e ankimit për rezultatin përfundimtar.  <i>Ref. Dok. Nr 4 Rregullore e pergjithshme e IAL</i>			
<b>Kriteri 8.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	Studenti në përfundim të mbarimit të studimeve pranë Kolegjit Universitar Reald, pajiset me listën e notave, suplementin e diplomës dhe diplomën, formati i së cilës është miratuar nga MASR (Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë), në përputhje me Dekretin Nr. 10, të datës 30.03.2020.  <i>Ref. Dok. Nr 4 Rregullore e pergjithshme e IAL</i>			
<b>Kriteri 9.</b> Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Studenti në përfundim të studimeve nëpërmjet një kërkesë drejtuar Sekretarise Mësimore, pajiset me dokumentacionin përkatës zyrtar të nevojshem.  <i>Ref. Dok. Nr 4 Rregullore e pergjithshme e IAL</i>			
<b>Kriteri 10.</b> Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentët nëse kërkohen.	Institucioni ruan në arkivat e tij, për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit  <i>Ref. Dok. Nr 4 Rregullore e pergjithshme e IAL</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	
<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

#### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

##### Standardi IV.1

**Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
-----------------	-------------------------------

Adresa: "Rruga e Durrësit", nr. 219, Tiranë


E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 42


<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni i arsimit të lartë mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>GVJ nisur nga dokumentat e vëna në dispozicion nga institucioni konstatoi se, institucioni ka një tabelë përmbledhëse me të dhënat e personelit të angazhuar në Master Profesional në “Fizioterapi” në “Fizioterapi”</p> <p>Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të jashtëm dhe të brendshëm dhe nuk ka të përfshirë personelin ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ.</p> <p>Tabela përmbledhëse mbi të dhëna për stafin akademik ndër vite, si dhe ngarkesë n më simore janë të detajuara në tabelën për mbledhëse, referuar dokumentit 121, sipas viteve: 2018-2019, 2019-2020, 2020-2021. Po kështu referuar Evidencës nr.99 mbi ngarkesën mësimore dhe angazhimin e stafit akademik në diplomën Master Profesional në “Fizioterapi”, për vitet akademike 2018-2019, 2019-2020, 2020-2021, vihet re se pedagogët profesionist të fizioterapisë janë vetëm 3 pedagog të jashtëm të cilët janë 2 me Msc dhe 1 me MP.</p> <p><i>Ref Dok. Nr.97: Të dhëna për stafin akademik ndër vite</i>  <i>Ref Dok. Nr.98 Ngarkesa totale e stafit akademik për MP në Fizioterapi për vitet akademike 2018-2019, 2019-2020</i>  <i>Ref Dok. Nr.121 Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB për MP Fizioterapi</i></p>
<p><b>Kriteri 2</b> Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në institucion, në takimin me zyrën e burimeve njerëzore dhe dokumentave të vëna në dispozicion konstatoi se procedura e rekrutimit të stafit akademik të brendshëm dhe të jashtëm ishte si mëposhtë. Departamenti në bazë të nevojave dhe ngarkesës mësimore paraqet kërkesën dhe kriteret e pranimit te dekani, më pas dekani paraqet kërkesën te rektori, rektori e paraqet në senatin akademik këtë kërkesë dhe merr miratimin e senatit. Pas miratimit nga senati, rektori merr vendimin për hapjen e procedurave të rekrutimit së bashku me kriteret dhe dokumentacionin përkatës.</p> <p>Pas mbylljes së afatit të dorëzimit të dokumentave, rektori ngre komisionin <i>ad-hoc</i>, për shqyrtimin e dosjeve të aplikantëve. Komisioni <i>ad-hoc</i> pasi bën shqyrtimin e dosjeve dhe intervistimin e kandidatëve ja përcjell rektorit për miratim. Rektori listën e fituesve ja përcjell dekanit për ndarjen e ngarkesës mësimore si dhe zyrës së burimeve njerëzore për fillimin e marrdhënieve të punës. GVJ gjatë vizitës në institucion, vëzhgoi në mënyrë të rastësishme 2 dosje të pedagogëve: Një pedagogu të jashtëm dhe një pedagogu të brendshëm. Në dosje ishin dokumentat e mëposhtëme: Kërkesa për staf akademik dhe aplikimi në njësinë përkatëse, CV, kopje diplome dhe listë note të noterizuara të ciklit të parë dhe të dytë të studimeve, dëshmi e gjuhës së huaj, referenca nga punëdhënësi i fundit, Fotokopje e kartës së identitetit, letër motivimi,</p>



	<p>fotokopje e gradës apo titullit, certifikata trajnimi apo botime shkencore.</p> <p>Mungonte në dosje: Kontrata e lidhur me institucionin (mbahej në një dosje më vete) si dhe raporti mjeko ligjor.</p> <p><i>Ref. Dok Nr 101: Procedura për rekrutimin e stafit akademik në IAL</i> <i>Ref. Vizita në institucion</i></p>								
<p><b>Kriteri 3</b> Institucioni i arsimit të lartë harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>GVJ bazuar në dokumenta e vëna në dispozicion, konstaton se Institucioni harton procedura e kritere për rekrutimin e personelit akademik të brendshëm dhe të jashtëm dhe i bën ato publike. Këto procedura janë të shprehura qartë dhe në referencën 103 “<i>Procedura për rekrutimin e stafit akademik në IAL</i>”</p> <p>GVJ konstatoi se ka një procedurë për rekrutimin e stafit akademik që janë të përfshirë në mësimdhënie: Përgjegjësi i departamentit bën kërkesë dekanit, për staf akademik ose ndihmës akademik bazuar në ngarkesën dhe programin mësimor duke përcaktuar dhe kriteret e rekrutimit. Dekani bën kërkesë rektorit për staf akademik, bazuar në kërkesën e Përgjegjësit të Departamentit. Rektori miraton në senat këto kërkesa, dhe më pas hapet konkursi për pedagog ku përcaktohen qartë: afatet e dorë zimit të dokumentave, dokumentat që duhen dorëzuar, kriteret që duhet të plotësoj kandidati, data e konkursit në komisionin <i>ad-hoc</i> (konkurs me dosje dhe intervistë). Pas shpalljes së fituesve, me shkresë përcjellë se dekanati ja përcjell rektoratit, bëhet me dije dhe ata persona që nuk kualifikohen (arsyet).</p> <p>GVJ si konkluzion mendon se institucioni ka procedurë të rregullt për rekrutimin e stafit akademik.</p> <p><i>Ref. Nr 103 “Procedura për rekrutimin e stafit akademik në IAL</i> <i>Ref.Nr 103 CV</i></p>								
<p><b>Kriteri 4</b> Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin dhe në GVB rezulton se Institucioni GVJ konstatoi se institucioni kishte dhe zbatonte procedurën e rekrutimit të stafit, përfshirë kritere të përgjithshme dhe specifike për përzgjedhjen e personelit të kualifikuar dhe në përputhje me përmbajtjen e programit të studimitsh procedura e rekrutimit për staf akademik për: gjuhën italiane, shqipe etj.</p> <p><i>Ref. Nr 69 Njoftim për aplikim për rekrutimstaf akademik.</i> <i>Ref. Nr70 Kontrat pune për staf akademik me kontrarë- Pedagog i jashtëm</i> <i>Ref Nr 71 Kontrat pune për staf akademik të brendshëm</i> <i>Ref.Nr 101 “ Procedura për rekrutimin e stafit akademik në IAL</i></p>								
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="550 1836 790 1904">Përmbushet</th> <th data-bbox="790 1836 997 1904">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="997 1836 1212 1904">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1212 1836 1468 1904">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="550 1904 790 1948"></td> <td data-bbox="790 1904 997 1948"></td> <td data-bbox="997 1904 1212 1948"></td> <td data-bbox="1212 1904 1468 1948" style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

**Standardi IV.2****Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>			
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	Gjatë vizitës në institucion GVJ konstatoi se institucioni ishte munduar të krijonte ambiente të përshtatshme për kryerjen e detyrave të personelit, por GVJ mendon se nuk janë të mjaftueshme, pasi kishte zyra të përbashkëta të stafit psh: biblioteka me zyrën e IT. <i>GVJ rekomandon KU Reald të shtojë dhe përmirësojë më tej amjentet për stafin akademik dhe administrative.</i>  <i>Ref. Vizita në institucion</i>			
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	GVJ nuk u informua për ndonjë trajnim të stafit akademik i cili mbulon mësimdhënien në lëndët profesionale, në diplomën MP në “Fizioterapi”, pasi nuk pati asnjë pedagog që ishte i angazhuar në lëndët profesionale të MP në “Fizioterapi”.  GVJ konstaton se edhe në akreditimine vitit 2020 janë lënë disa rekomandime, specifikisht rekomandimi 5 për cilësinë e stafit që mbulon mësimdhënien në diplomën MP Fizioterapi, ky rekomandim është plotësuar pjesërisht, pasi rekrutimet e bëra nuk kanë specialitet të duhur për MP Fizioterapi.  <i>Ref. Nr 73: Relacion përfundimtar. Rekomandimet e plotësuara-MPFizioterapi. Pika 5.</i> <i>Ref. Vizitë në institucion</i>			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimitor-shkencor.	Gjatë takimit me zv. Rektorin, zv. Dekanen drejtuesen e departamentit, një pjesë të stafit akademik, si dhe referuar evidencave të vëna në dispozicion, GVJ konstaton se Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik dhe mësimdhënien. Kjo gjë ishte më e prekshme sidomos gjatë viteve akademike 2019-2020, 2020-2021, për shkak të COVID -19.  <i>Ref. Dok. Nr 78 Google Clasroom manuali student</i> <i>Ref. Nr 79 Google Clasroom manuali pedagogu</i> <i>Ref. Nr 80 Manual për programin OBS për rregjistrim video dhe audio</i>			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.	Institucioni ka një angazhim dhe dëshirë optimale të burimeve njerëzore për të bërë të mundur rekrutim të stafit akademik me përvoja akademike dhe profesionale, por akoma nuk mund të themi që ka një staf me tituj dhe grada sipas Ligjit 80/2015, të Arsimit të Lartë të Shqipërisë, në referencën 19 vrehet se:  <table border="1" style="margin-left: auto; margin-right: auto;"> <tr> <td style="text-align: center;">Stafi akademik i</td> <td style="text-align: center;">Viti</td> <td style="text-align: center;">Viti</td> </tr> </table>	Stafi akademik i	Viti	Viti
Stafi akademik i	Viti	Viti		



	programit MP ne "Fizioterapi"		akademik 2020-2021		akademik 2019-2020	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof Dr	-	-	-	-	-	-
Prof.Assoc	-	-	1	-	-	-
Dr/PhD	2	2	3	1	3	1
Msc	1	3	2	3	2	3
MP	1	-	1	-	1	-
Ne total	4	5	7	4	7	4

GVJ mendon se duhet të jetë objektiv rekrutimi i stafit me grada dhe tituj sipas ligjshmërisë së arsimit shqiptar si dhe të ketë një numër më të madh PAE, krahasuar me PAK.

Ref. Dok. Nr 19 Stafit akademik i Njësisë bazë për vitin akademik 2020-2021.

Ref. Dok. Nr 21 Lista e stafit akademik të angazhuar në MP Fizioterapi 2018-2019, 2019-2020

Ref. Dok. Nr. 121 Tabela përmbledhese

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

### Standardi IV.3

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	<p>GVJ gjatë vizitës në institucion, bazuar dhe në dokumenta të vëna në dispozicion, mendon se ky institucion siguron mjedise të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimore teorike (auditorë për leksione, seminare), hapsira që përputhen me numrat e studentëve në MP Fizioterapi (numri i studentëve në MP Fizioterapi varioje nga 1 student deri në 6 student sipas viteve akademike).</p> <p>Po kështu në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit, MP Fizioterapi institucioni ka siguruar një kabinet fizioterapie në katin e dytë. Kabineti është i pajisur me shtretër dhe një aparaturë që ndihmon në realizimin e praktikave lëndore, laboratoreve të lëndëve profesionale në MP Fizioterapi.</p> <p>GVJ, lidhur me këtë kriter, konstaton se edhe në akreditimin e vitit 2020, janë lënë disa rekomandime, specifikisht rekomandimi 12 për ngritjen e strukturave mësimore qëndihmojnë në realizimin e programit mësimor në diplomën MP Fizioterapi, ky rekomandim mendohet se është plotësuar</p>

	<p>pjesërisht, përse i përket paisjeve për MP Fizioterapi.</p> <p>GVJmendon se duhet plotësuar edhe me aparatura tjetra bazë në kabinetet e fizioterapisë, që ndihmojnë për realizimin e një program kryesisht praktikave sa më cilësore të studentëve të MP Fizioterapi.</p> <p><i>Ref. Dok. Nr 73. Relacion përfundimtar. Rekomandimet e plotësuara-MPFizioterapi. Pika 12.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Gjatë inspektimit të institucionit, GVJ konstatoi se në këtë institucion ka ambiente fizike të mjaftueshme në m<sup>2</sup> dhe të paisura me vidioprojektor, njësi kompjuterike të cilat ndihmojnë në realizimin e procesit mësimor. Ashtu sic ka dhe ambiente të cilat ishin të paplotësuar me infrastrukturën e caktuar, pasi pritëshin të pajisen me infrastrukturën e duhur në varësi të rregjistrimeve të studentëve.</p> <p><i>Ref. Dok. Nr.37 Infrastruktura e IAL</i> <i>Ref. Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Institucioni siguron sipas GVJ-së, hapsirat, auditorët, laboratorët të cilat ndihmojnë në realizimin cilësor të programit mësimor jo vetëm të pjesës teorike por edhe praktike-laboratorike. IAL ka në infrastrukturën e tij disa laborator si laborator i: kimisë, farmacisë, anatomisë, fiziologjisë, fizioterapisë, informatikës, stomatologjisë etj</p> <p><i>Ref. Dok. Nr.37 Infrastruktura e IAL.</i> <i>Ref. Dok. Nr.77Laboratorët në IAL</i> <i>Ref. Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/eve të studimit që ofron.</p>	<p>IAL siguron një kabinet të informatikës, i cili ishte i plotësuar me tavolina kompjuteri si dhe kompjutera për cdo tavolinë, të cilët kishin programe profesionale të instaluar në ndihmë të realizimit të programit mësimor për studentët e MP Fizioterapi, por jo vetëm, por dhe për studentët e diplomave të tjera.</p> <p><i>Ref. Dok. Nr.77Laboratorët në IAL], [Vizita në institucion]</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe /ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike</p>	<p>IAL për të siguruar një cilësi të realizimit të programit mësimor MP Fizioterapi, krahas infrastrukturës institucionale, zotëron edhe disa marrëveshje bashkëpunimi për realizimin e këtyre praktikave mësimore në disa Institucione publike dhe jo publike. GVJ konstatoi disa kontrata bashkëpunimi si me:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin e Mjekësisë Tiranë</li> <li>2. Marrëveshje me Spitalin Rajonal Vlorë</li> <li>3. Marrëveshje bashkëpunimi me institucione për realizimin e praktikave mësimore,</li> </ol>

	4. Marrëveshja me Universitetin e Fogias. <i>Ref. Dok. Nr25 Marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin e Fogias.</i> <i>Ref. Dok Nr 27 Marrëveshje bashkëpunimi me Spitalin Rajonal Vlorë</i> <i>Ref. Dok. Nr 28 Marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin e Mjekësisë Tiranë.</i> <i>Ref. Dok. Nr 29 Marrëveshje bashkëpunimi me institucione për realizimin e praktikave mësimore.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

#### Standardi IV.4

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	IAL, Kolegji Universitar “Reald” në Vlorë, në infrastrukturën e institucionit ka një bibliotekë institucionale, për të gjithë studentët e programeve të studimit që janë në këtë Kolegj.  Biblioteka fizike është me një larmi literature, rreth 2500 copë libra nga të cilat 500 copë janë blerë në Qershor 2020, por për diplomën MP Fizioterapi nuk gjetëm ndonjë literaturë fizike.  Biblioteka funksionon edhe on-line, por përsëri kishte shumë pak literaturë për studentët dhe pedagogët e MP Fizioterapi. Biblioteka shfrytëzohet nga cdo student dhe pedagog edhe fizikisht edhe on- line ne cdo kohë, falas.  <i>Ref. Dok. Nr.36 Libra të rinj të shtuar në bibliotekën e IAL në vitin 2020.</i> <i>Ref. Vizitë në institucion.</i>
<b>Kriteri 2.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	GVJ gjatë vizitës në institucion si dhe dokumentave të vëna në dispozicion, konstaton se në IAL ka një bibliotekë on line me 2500 libra, nga të cilat 55 libra të blera në Qershor 2020, si dhe bibliotekën on-line.  GVJ pavarësisht pranisë së gjithë kësaj literature për programet e ndryshme të studimit të kësaj IAL-je, nuk ka pothuajse fare literaturë për lëndët profesionale të programit MP Fizioterapi.  Edhe pse është lënë rekomandim dhe në akreditimin e vitit 2020refruar evidence nr 73, pika 11, për pasurimin e bibliotekës me literaturë në gjuhën shqipe dhe të huaj, përsëri kjo bibliotekë nuk ka literaturë për programin e studimitMP Fizioterapi që t’i përshtatet programit specifik.  <i>Ref. Dok. Nr.36 Libra të rinj të shtuar në bibliotekën e IAL në vitin 2020.</i> <i>Ref. Dok. Nr.73. Pika 11. Relacioni përfundimtar. Rekomandimet e</i>



	<i>plotësuara për MP Fizioterapi.</i> <i>Ref. Vizita në institucion</i>			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.	GVJ gjatë vizitës në institucion u informua se studentët dhe pedagogët që janë pjesë e IAL-së, kanë të drejtë pa pagesë dhe pa asnjë pengesë të shfrytëzojnë bibliotekën fizike dhe atë on-line në cdo kohë.  <i>Ref. Vizita në institucion</i>			
<b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	Gjatë vizitës në institucion GVJ vuri re se në bibliotekë kishte një kompjuter me programet përkatëse, të cilat mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.  GVJ mendon se paisja jo vetëm me një kompjuter është shumë pak për tu shrytëzuar nga studentët, por edhe mungesa e tavolinave për shfrytëzimin e bibliotekës fizike do ta vështirësonte shfrytëzimin e bibliotekës fizike.  <i>Ref. Vizita në institucion</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë e të zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	GVJ nisur nga vizita në institucion mendon që është domosdoshmëri hartimi i njëplani për shtimin e literaturës fizike për diplomën MP Fizioterapi, si dhe hartimi i një plan buxheti për paisjen dhe rinovimin e literaturës në bibliotekën e IAL-së.  <i>GVJ rekomandon që ti kushtohet një plan i detajuar dhe buxhet për shtimin e literaturës fizike dhe on-line, specifike për programin e studimit MP Fizioterapi</i>  <i>Ref. Dok Nr.36 Libra të rinj të shtuar në bibliotekën e IAL në vitin 2020.Ref. Dok. Nr.73. Pika 11. Relacioni përfundimtar. Rekomandimet e plotësuara për MP Fizioterapi.</i>  <i>Ref. Vizita në institucion.</i>			
<b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj	GVJ mendon se biblioteka ju vihet në dispozicion studentëve dhe pedagogëve të Kolegjit Universitar “Reald”, në orare të ndryshme që nuk pengojnë procesin mësimor.  <i>Ref. Vizita në institucion</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

#### Standardi IV.5

**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit.**

#### Kriteret

**Vlerësimi i ekspertëve**

<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni ka një sistem menaxhimi dhe bashkëveprimi nëpërmjet zyrës së karrierës, në këtë sistem menaxhimi elektronik sekretaria hëdh të dhënat, pedagoget hedhin të dhënat. Zyra e karrierës administrojnë dhe mbledh të gjithë të dhënat lidhur me studentët nga regjistrimi i tyre, diplomimi dhe deri në punësimin e tyre. Bazuar dhe në evidence nr 8 Rregullore e këshillit të karrierës e miratuar nga Senati Akademik i Kolegjit Universitar “Reald” me vendim nr 19 datë 01/08/2017.</p> <p><i>Ref. Dok. Nr.8 Rregullore e këshillimit të karrierës</i> <i>www.unireald.edu.al</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se IAL administrojnë informacionin, dokumentacionin për aktivitetin e personelit akademik dhe ndihmës akademik. Administrimi i cdo dokumentacioni bëhet në formë shkresore dhe elektronike. Bazuar dhe në urdhrin e rektorit për rregulloren e standartizimit të procedurave për hartimin, administrimin e dokumentacioneve zyrtare.</p> <p>Gjithashtu nga IAL bëhet vlerësimi i performancës vjetore me anë të një formulari vetëvlerësimi i cili plotësohet elektronikisht dhe ruhet dhe në formë shkresore. Ky formular plotësohet nga stafi akademik, ndihmës akademik sipas rubrikave me radhe: ngarkese mësimore në bachelor dhe në master, aktivitet shkencor (konferenca, botime, libra të botuar etj), sa diploma ka udhëhequr, trajnime etj</p> <p><i>Ref. Nr.62 Rregullore e standartizimit të procedurave për hartimin, administrimin e dokumentacioneve zyrtare.</i> <i>Ref. Nr.88 Formular vetëvlerësimi i pedagogut 2019-2020.</i> <i>Ref. Evidenca Nr.90 Raporti vjetor i kërkimit shkencor 2019-2020.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>IAL nëpërmjet faqes zyrtare <a href="http://www.unireald.edu.al">www.unireald.edu.al</a> siguron akses për pedagog dhe student për të marr informacion në cdo kohë gjithçka lidhet me programin mësimor (kurrikula, orare, stafin pedagogjik, njoftime të ndryshme të IAL-së).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në IAL konstatoi se bazuar në sistemin e menaxhimit të brendshëm, faqes zyrtare të institucionit <a href="http://www.unireald.edu.al">www.unireald.edu.al</a>, dhe platformave on-line si: Google Classroom manuali student, Google Classroom manuali pedagogu, Manual për programin OBS për regjistrim video dhe audio, të cilat gjetën përdorim të madh gjatë kohës së pandemisë së COVID-19, bëhet e mundur komunikimi interaktiv midis studentëve dhe stafit akademik të IAL-së.</p> <p><i>Ref. Dok. Nr 78 Google Classroom manuali student</i> <i>Ref. Dok. Nr 79 Google Classroom manuali pedagogu.</i> <i>Ref. Dok. Nr 80 Manual për programin OBS për regjistrim video dhe</i></p>

	<i>audio.</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	<p>Ky sistem menaxhimi bën të mundur dhe garanton një monitorim në kohë reale të mbarëvajtjes së procesit mësimor.</p> <p>Falë këtij menaxhimi të brendshëm sistemit elektronik bëhet e mundur identifikimi në kohë reale mangësira ose crregullime të mbarëvajtjes së programit mësimor.</p> <p>Cdo student me anë të adresës së tij elektronike dhe pyetësorëve të ndryshëm anonim shpreh mendimet për cdo problematik që mund tëkonstatojë (planin mësimor, infrastrukturën, bashkëveprimin me stafin akademik, ndihmës akademik, administratën, sekretarinë mësimore, mësimdhënien) etj.</p> <p>Kjo bën jo vetëm konstatimin e problematikave, por dhe informimin në kohë reale të drejtuesve tëinstitucionit, si dhe zgjidhjen në kohën e duhur të problematikave të hasura.</p> <p><i>Ref. Dok. Nr.86 Pyetësor për studentin- Formular vlerësimi aktiviteti NJSBC.</i></p> <p><i>Ref. Dok. Nr.87 Pyetësor Formular NJSBC Vlerësimi i studentit për pedagogun], [www.unireald.edu.al]</i></p>			
<b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe	<p>GVJ konstatoi se në faqen zyrtare <a href="http://www.unireald.edu.al">www.unireald.edu.al</a>, janë të publikuara planet mësimore, orare, aktivitete shkencore të IAL-së, orare të ndryshme Bachelor dhe për Master, data e sezonit,departamentet, stafi akademik, rregullore të ndryshme etj.</p> <p>I gjithë informacioni në faqen zyrtare është në gjuhën shqipe dhe italisht</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

#### Standardi IV.6

**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	<p>GVJ refruar evidencës nr 39, Raport mbi koston financiare të MP Fizioterapi dhe evidencës nr 40, Raporti financiar 2020, mendon se Kolegji Universitar “Reald”, harton cdo vit një raport financiar mbi kostot e programeve të studimit, harton buxhetin për bibliotekën, infrastrukturën, mbështetjen e personelit akademik dhe aktiviteteve shkencore të universitetit.</p> <p><i>Ref. Dok. Nr.39 Raport mbi koston financiare të MP Fizioterapi.</i></p>

	<i>Ref. Dok. Nr.40 Raporti financiar 2020.</i>
<b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologji mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.	<p>Bazuar referencave përkatëse vërehet se IAL ka një raport financiar të detajuar për mbarëvajtjen e programeve mësimore sipas zërave: mësimdhënie, kërkimin shkencor, pagat e personelit, infrastrukturën, zhvillimin e personelit.</p> <p><i>Ref. Dok. Nr.39 Raport mbi koston financiare të MP Fizioterapi.</i> <i>Ref. Dok. Nr.40 Raporti financiar 2020</i></p>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.	<p>Institucioni siguron auditim të brendshëm cdo vit. Zyra e Financës që administron të gjithë aktivitetin financiar, bën cdo vit një raport vjetor, duke pasqyruar me hollësi cdo zë të financës si: realizimin e planifikimeve të bëra në plan buxhetin e vitit, të ardhurat nga tarifa studentore, shpërndarjen e buxhetit për mësimdhënie, kërkimin shkencor, pagat e personelit, infrastrukturën, zhvillimin e personelit etj. Institucioni gjithashtu në bashkëpunim me zyrën e financës harton plan buxhetin e vitit të ardhshëm akademik.</p> <p><i>Ref. Dok. Nr.40 Raporti financiar 2020</i></p>
<b>Kriteri 4.</b> Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.	<p>Institucioni në bashkëpunim me zyrën e financës, krahas raportit vjetor financiar, dokumenton dhe bën edhe një raport të detajuar mbi koston financiare të një cikël studimi Bachelor për 3 vitet e kaluaradhe MP për 1 vit. Bazuar në këtë analizë të kostove financiare institucioni planifikonecurinë dhe mbarëvajtjen normale të programit të studimit.</p> <p><i>Ref. Dok.Nr.40 Raporti financiar 2020</i></p>
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni i arsimit të lartë duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të	<p>GVJ konstaton se Kolegji Universitar “Reald” ka 6 programe studimi Bachelor, 4 diploma MP, 3 diploma MSH.</p> <p>Po kështu programii studimit MP Fizioterapi është hapur që në 2018 me 4 studentë të rregjistruar, 2019 me 6 studentë të rregjistruar, 2020 me 6 student të rregjistruar.</p> <p>Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare, dhe ka</p>

ardhurave të domosdoshme në të ardhmen	kapacitet financiare të mjaftueshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit, pavarësisht se ka një numër të vogël studentësh.  <i>Ref. Dok. Nr.35 Rregjistri i studentëve –AMZA, MP Fizioterapi.</i> <i>Ref. Nr.38, Poster informimi për publikun Reald-2020.</i> <i>Ref. Dok. Nr.39 Raport mbi koston financiare të MP Fizioterapi.</i> <i>Ref. Dok. Nr.40 Raporti financiar 2020.</i> <i>Ref. Dok. Nr.121, Tabelat përmbledhëse për aneks RVB MP Fizioterapi.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<b>Standardi V.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>GVJ bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion vë re se, ky institucion ka një rregullore të institucionit, qëmbulon ciklin e plotë të studimeve, që nga mararja e statusit të studentit deri në diplomimin e tij, duke shprehur qartë të drejtat dhe detyrat e studentit.</p> <p>Referuar Evidenca nr 5, Rregullore e Fakultetit të Shkencave Mjekësorekreu 3,4,5,6,7.</p> <p>GVJ gjatë vizitës nëinstitucion, në guidë kishte planifikuar takimin me studentët, për të marrë informacione nga vetë studentët, por nuk u realizua takimi pasi nuk kishte ardhur studenti (një student për vitin akademik 2020-2021).</p> <p>Institucioni sipas GVJ, bazuar në RVB dhe referencat përkatëse konfirmon se institucioni garantojnë barazinë dhe të drejta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit në Kolegjin Universitar “Reald”, Vlorë.</p> <p><i>Ref. Dok. Nr.4, Rregullore e Përgjithëshme e IAL, Kreu 5,6,7,8,9,10.</i> <i>Ref. Dok. Nr 5, Rregullore e Fakultetit të Shkencave Mjekësore Kreu 3,4,5,6,7.</i> <i>Ref. Dok. Vizita në institucion.</i></p>
<b>Kriteri 3.</b> Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së	Referuar takimit me drejtuesit e institucionit, RVB si dhe Programit studimit Master Profesional në Fizioterapi. Kriteret e pranimit dhe

<p>studentëve, përparimit përgjatë ndjekjes së programit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>vlerësimit, referuar evidence nr 14, konstatohet se procedura e pranimit të studentëve bëhet bazuar në: kuotat dhe kriteret e miratuara nga senati akademik i institucionit dhe më pas nga MASR. Pranimi i kandidatëve për Master Profesional bëhet me konkurim dosjeje si edhe me anë të një interviste me gojë përpara një komisioni të caktuar nga përgjegjësi i departamentit. Kriter është që student të ketë mbaruar Bachelor në Fizioterapi, në kriteret e pranimit do të merret parasysh mesatarja e notës e nivelit Bachelor sipas sistemit zbritës mbështetur tek kuota e pranimit. Përgjegjësi i Departamentit shpall vendimin e motivuar të pranimeve ose mospranimeve në MP. Ankesat kundër vendimit të Departamentit bëhen në Dekanatin e Fakultetit të Shkencave Mjekesore, i cili shpall vendimin e tij brenda 5 ditëve nga paraqitja e ankesës.</p> <p>Përvec fazës së pranimit të studentëve, studenti ka të drejtë të transferohet apo të çrregjistrohet.</p> <p>Të gjitha informacionet mbi kuotat, kriteret e pranimit në MP Fizioterapi janë të publikuara në faqen zyrtare të institucionit <a href="http://www.unireald.edu.al">www.unireald.edu.al</a> dhe janë të aksesueshme nga publiku, studentët e interesuar për të vazhduar studimet në Kolegjin Universitar 'Reald' në Vlorë.</p> <p><i>Ref. Dok. Nr 5, Rregullore e Fakultetit të Shkencave Mjekesore.</i>  <i>Ref. Dok. Nr 14, Programi Mësimor Master Profesional në Fizioterapi, Kriteret e pranimit dhe vlerësimit.</i>  <i>Ref. Dok. Vizita në institucion.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve.</p>	<p>Institucioni çdo fundviti planifikon kuotat e pranimit dhe kriteret e pranimit për vitin e ri akademik për çdo program studimi dhe në vecanti edhe për MP në Fizioterapi.</p> <p>Kuotat dhe kriteret propozohen nga departamenti, këto propozime kalojnë në Dekanat, më pas në Rektorat dhe miratohen në Senatin Akademik të Institucionit, dërgohen në MARS ku marrin miratimin e kuotave dhe kriterëve të pranimit.</p> <p>I gjithë ky informacion gjendet në formë elektronike në faqen zyrtare të institucionit dhe është e aksesueshme nga të gjithë të interesuarit si dhe në formë shkresore.</p> <p><i>Ref. Dok. Nr 5, Rregullore e Fakultetit të Shkencave Mjekesore.</i>  <i>Ref. Vizita në institucion</i>  <a href="http://www.unireald.edu.al">www.unireald.edu.al</a></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e</p>	<p>Institucioni çdo fundviti dhe fillim viti akademik bën prezantimin dhe reklamimin e institucionit bazuar në infrastrukturën, kuotat, kriteret e pranimit, tarifën e studimit, programin e studimit etj, me anë të posterave të ndryshme, mediave, Open Day etj.</p>

përgjithshme e të veçanta të programit të studimit	<p>Por pavarësisht informimit të publikut interesi i studentëve për të vazhduar studimet në Kolegjin Universitar “Reald” Vlorë në programin e studimit MP Fizioterapi është shumë i vogël</p> <p><i>Ref. Dok. Nr.37, Infrastruktura e IAL.</i>  <i>Ref. Dok. Nr.38 Poster informimi për publikun- Reald 2020</i>  <i>Ref. Vizita në institucion.</i>  <a href="http://www.unireald.edu.al">www.unireald.edu.al</a></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	
			X	

<b>Standardi V.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	<p>GVJ gjatë vizitës në institucion si dhe takimin me sekretarinëmësimore, konstatoam se institucioni ka dokumenta (procesverbalet e notave), regjistra të studentëve ku pasqyrohet përparimi akademik i studentëve si dhe përmbylljen e programit të studimit MP Fizioterapi. Ky informacion mund të merret edhe në faqen zyrtare të institucionit.</p> <p>Studentët gjithashtu në portalin e studentit ndjekin ecurinë akademike të tyre.</p> <p><i>Ref. Dok. Nr.33 Studentët e Rregjistruar MP Fizioterapi.</i>  <i>Ref. Dok. Nr.32 Studentët e diplomuar MP Fizioterapi 2019-2020(3 student), 2020-2021(1 student).</i>  <i>Ref. Dok. Nr.99, Rrregjistër kursi MP Fizioterapi.</i></p>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesëshme.	<p>Bazuar në RVB, Institucioni i informon studentët për kualifikimet dhe studimet e pjesëshme, sidomos gjatë transferimeve ose programeve të dyta të studimeve.</p> <p>GVJ konstaton se kjo procedurë parashikohet në Rregullore e Përgjithëshme e IAL, Rregullore e Fakultetit të Shkencave Mjkësore, por e pamundur për t’u pohuar nga studentët pasi nuk kishim student në takim.</p> <p><i>Ref. Dok. Nr.4, Rregullore e Përgjithëshme e IAL.</i>  <i>Ref. Dok. Nr.5, Rregullore e Fakultetit të Shkencave Mjkësore.</i></p>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	<p>Institucioni që në fillim të vitit akademik në faqen zyrtare të institucionit, në programin e studimit dhe syllabuset e lëndëve janë të përshkruara qartë procedura dhënënyra e vlerësimit të dijeve</p> <p><i>Ref. Dok. Nr.19, Syllabuset 2020-2021 në MP Fizioterapi</i>  <i>Ref. Dok. Nr.4, Rregullore e Përgjithëshme e IAL.</i></p>

	<i>Ref. Dok. Nr 5, Rregullore e Fakultetit të Shkencave Mjekësore</i>			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Institucioni ka një rregullore të mënyrës së punimit të temës së diplomës referuar RVB-së dhe referencave. <i>Ref. Dok. Nr 5, Rregullore e Fakultetit të Shkencave Mjekësore</i> <i>Ref. Nr.9, Rregullore e diplomimit</i> <i>Ref. Nr.17 Model diploma MP Fizioterapi</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit	GVJ sic u përmend dhe në kriteret e mësipërme, konstaton senë mënyrë të vazhdueshme çdo fundviti dhe fillim viti, institucioni publikon on line në faqen zyrtare <a href="http://www.unireald.edu.al">www.unireald.edu.al</a> , si dhe me anë të posterave, mediave, ditët e informimit, informon të gjithë të interesuarit për studime në MP Fizioterapi mbi programin e studimit, infrastrukturën, rregulloret e ndryshme. GVJ mbështet vetëm në evidence 37, 38. <i>Ref. Dok. Nr.37, Infrastruktura e IAL.</i> <i>Ref. Dok. Nr.38 Poster informimi për publikun- Reald 2020</i> <i>Ref. Vizita në institucion</i> <a href="http://www.unireald.edu.al">[www.unireald.edu.al]</a>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

### Standardi V.3

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Institucioni informon studentët për programin mësimor, strukturën e planit mësimor (lëndë bazë, lëndë karakterizuese, lëndëndërdisiplinore/integruese, lëndë plotësuese, detyrime përmbyllëse), mënyrën e kontrollit të dijeve e shprehur në syllabuset e lëndëve, kohëzgjatjen e studimeve.  Institucioni informon studentët jo vetëm në formë elektronike në faqen zyrtare dhe në takime të vazhdueshme që realizon me studentët.  Bazuar në planin mësimor GVJ konstaton se plani mësimor ka 60 Kredite, zhvillohet në një vit akademik dhe ka dy semestra me 30 kredite cdo semestër.  <i>Nuk është e qartëkuivalentimi i një krediti me orë mësimor për zërat: lexion, seminar, laborator, praktika profesionale</i>  <i>Ref. Dok. Nr.12 Plani mësimor MP Fizioterapi 2019-2020</i> <i>Ref. Dok.Nr. 18 Syllabuset MP Fizioterapi 2019-2020</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve të	GVJ sic u shpreh dhe më lart konstaton se institucioni vë në dispozicion të studentëve planin mësimor, syllabuset përkatës dhe udhëzues për



programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	lëndët dhe module të vecanta, sipas rregullores së Fakultetit të Shkencave Mjekësore.  <i>Ref. Dok. Nr.5 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Mjekësore</i> <i>Ref. Dok. Nr.12 Plani mësimor MP Fizioterapi 2019-2020</i> <i>Ref. Dok. Nr. 18 Syllabuset MP Fizioterapi 2019-2020</i> <i>Ref. Vizita në institucion</i>			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Zyra e karrierës në mënyrë të vazhdueshme studion dhe tregun e punës, për të ndihmuar studentët që diplomohen për integrimin e tyre në tregun e punës.  <i>Ref. Dok. Nr.8 Rregullore e këshillimit të karrierës</i> <i>Ref. Dok. Nr.32 Studentë të diplomuar MP Fizioterapi</i> <i>Ref. Dok. Nr.51 Studim tregu në fushën e shëndetësisë</i>			
<b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Institucioni që në momentin që student të Bachelor dëshirojnë të jenë student pranë këtij institucioni për MP Fizioterapi, njihen me programin mësimor, infrastrukturën, logjistikën që përdoret për realizimin e programit mësimor.  Institucioni këtë informacion studentëve ua vendos në dispozicion jo vetëm në takimet e koordinatorit, sekretarisë me studentët, por dhe në formë elektronike në faqen zyrtare të institucionit.  <i>Ref. Dok. Nr.8 Rregullore e Këshillimit të Karrierës</i> <i>Ref. Dok. Nr.3, Infrastruktura e IAL</i> <i>Ref. Dok. Nr.38 Poster informimi për publikun- Reald 2020</i> <a href="http://www.unireald.edu.al">www.unireald.edu.al</a>			
<b>Kriteri 5.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë	GVJ bazuar në dokumentat e vëna në dispozicion nga institucioni, mendon se institucioni me anë menaxhimit të brendshëm të informacionit, bën të mundur që cdo informacion për programe studimit të jetë i aksesueshëm nga të gjithë studentët dhe pedagogët nëpërmjet faqes zyrtare elektronike të institucionit.  <a href="http://www.unireald.edu.al">www.unireald.edu.al</a>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

#### Standardi V.4

**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë\*, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm**


#### Kriteret

#### Vlerësimi i ekspertëve

**Kriteri 1.** Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për


Institucioni disponon statistika vjetore mbi numrin e studentëve të rregjistruar, të çrregjistruar dhe të diplomuar. Referuar RVB-së dhe

<p>numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit.</p>	<p>dokumentave të vëna në dispozicion të GVJ rezulton si mëposhtë</p> <p>Student të diplomuarsipas viteve akademike:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ 2019-2020 janë diplomuar 3 studentë</li> <li>➤ 2020-2021 është diplomuar 1 student.</li> </ul> <p><i>Ref. Dok. Nr.32 Studentë të diplomuar MP Fizioterapi</i>  <i>Ref. Dok. Nr.33 Student të rregjistruar MP Fizioterapi</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>GVJbazuar në dokumentat e vëna në dispozicion, rregjistrin e studentëve, vizitën në institucion konstaton se institucioni zotëron informacion vjetor për rregjistrimin, c’rregjistrimin dhe diplomimin e studentëve MP Fizioterapi si më poshtë sipas viteve akademike</p> <p>Studentë të rregjistruar sipas viteve akademike:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ 2018-2019 - 5 studentë të rregjistruar</li> <li>➤ 2019-2020 - 6 studentë të rregjistruar</li> <li>➤ 2020-2021 - 6 studentë të rregjistruar</li> </ul> <p><i>Ref. Dok. Nr.32 Studentë të diplomuar MP Fizioterapi.</i>  <i>Ref. Dok. Nr.33 Student të rregjistruar MP Fizioterapi</i>  <i>Ref. Dok. Nr.99 Rrregjistër kursi MP Fizioterapi</i>  <i>Ref. Dok. Nr.35 rregjistri i studentëve-AMZA MP Fizioterapi</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.</p>	<p>Institucioni zotëron informacion sipas planit mësimor, për mbarëvajtjen e programit mësimor për cdo student, nga rregjistrimi deri në përfundimine studimeve. Institucion zotëron rregjistrin e notave të studentëve për të ndjekur ecurinë e vitit akademik. Referuar dokumentacioneve të mëposhtme.</p> <p><i>Ref. Dok. Nr.12 Plani mësimor MP-Fizioterapi 2019-2020</i>  <i>Ref. Dok. Nr.32 Studentë të diplomuar MP Fizioterapi</i>  <i>Ref. Dok. Nr.33 Student të rregjistruar MP Fizioterapi</i>  <i>Ref. Dok. Nr.35 rregjistri istudentëve-AMZA MP Fizioterapi</i>  <i>Ref. Dok. Nr.99 Rregjistër kursi MP Fizioterapi</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Institucioni në bazë të menaxhimit të brendshëm, sistemit IT, gjithë të dhënat për studentët janë të sigurt, por dhe të aksesueshme nga personat e interesuar.</p> <p><i>Ref. Dok. Nr.66 Vendim Senati Akademik Nr. 34 datë 9/05/2020 Për miratimin e rregullores Për mbrojtjen e të dhënave personale.</i>  <i>Ref. Dok. Nr.121 Tabelat përmbledhëse për aneksRVB-MP Fizioterapi</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e</p>	<p>GVJnë bazë të RVB dhe referencave përkatëse konstaton se institucioni harton raporte periodike mbi cilësinë e studentëve në hyrje, dalje të studentëve, punësimin e tyre. Por nuk konstatojmë masa për përmirësimin këtyre treguesve</p>



cilësisë të punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve	<p><i>Ref. Dok. Nr.26 Të dhëna mbi punësimin e studentëve 2018-2019.</i></p> <p><i>Ref. Dok. Nr.27 Marrveshje bashkëpunimi me Spitalin rajonal në Vlorë</i></p> <p><i>Ref. Dok. Nr.32 Studentë të diplomuar MP Fizioterapi.</i></p> <p><i>Ref. Dok. Nr.33 Student të rregjistruar MP Fizioterapi</i></p> <p><i>Ref. Dok. Nr.34 Nota mesatare në hyrje dhe dalje</i></p> <p><i>Ref. Dok. Evidence Nr.35 Rregjistri i studentëve -AMZA MP Fizioterapi</i></p> <p><i>Ref. Dok. Nr.99 Rrregjistër kursi MP Fizioterapi</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

<b>Standardi V.5</b> <b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.</b>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>Bazuar në RVB, në evidencat e vëna në dispozicion si: Statuti I Universitetit, Kreu 8 (Student dhe te dhëna mbi studentët), Rrregullorja e Fakultetit të Shkencave Mjekësore, Kreu 7, Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve në organet vendimmarrëse, por GVJ nuk realizoi takimin me studentët pasi nuk kishte student të MP në Fizioterapi, për tu informuar për këtë kriter.</p> <p><i>Ref. Dok. Nr.2 Statuti i KU "Reald".</i></p> <p><i>Ref. Dok. Nr.5 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Mjekësore, Kreu 7 Ref. Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Institucioni me anë të rregulloreve, statutit garanton përfshirjen e studentëve në vendimmarrje, vlerësimin mbi procesin akademik dhe realizimin e programit mësimor.</p> <p>GVJ nuk realizoi takimin me studentët pasi nuk kishte student të MP në Fizioterapi, për tu informuar për këtë kriter.</p> <p><i>Ref. Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit,</p>	<p>Institucioni bazuar në planin mësimor, rregulloren e Fakultetit të Shkencave Mjekësore, Statutin e Universitetit, modelin e syllabusi, regjistri i studentëve, institucioni ka parasysh ngarkesën e studentëve si dhe parashikon procedura jo burokratike për përparimin, njohjen e studimeve të mëparshme.</p> <p>GVJ nuk realizoi takimin me studentët pasi nuk kishte student të MP</p>



duke përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.	në Fizioterapi, për tu informuar për këtë kriter <i>Ref. Dok. Nr.2 Statuti I KU "Reald".</i> <i>Ref. Dok. Nr.5 Rrregullore e Fakultetit të Shkencave Mjekësore Kreu 7</i> <i>Ref. Dok. Nr.12 Plani mësimor për MP Fizioterapi 2019-2020</i> <i>Ref. Dok. Nr 18 Syllabusi MP Fizioterapi 2020-2021</i> <i>Ref. Dok. Nr.35 Rregjistri i studentëve AMZA MP Fizioterapi</i> <i>Ref. Vizita në institucion</i>			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga IAL për këtë, proces vlerësimin dhe takimin e realizuar në IAL me zyrat përkatëse, rezulton se studentëve ju mërr mendimi për rishikimin e kurikulave. Por GVJ e pati të pamundur të realizonte takimin me studentine MP në Fizioterapi, për tu informuar më tej për këtë çështje.			
<b>Kriteri 5.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	<i>Ref. Vizita në institucion</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

### Standardi V.6

**Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	GVJ bazuar në RVB, dhe dokumenta të vëna në dispozicion si: Rregullore e NJSBC, Rrregullore e zyrës së karrierës mendon se institucion ka njësin e kontrollit të brendshëm të cilësisë dhe zyrën e karrierës të cilat menaxhojnë informimin e studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore <i>Ref. Dok. Nr. 6 Rregullore e NJSBC</i> <i>Ref. Dok.Nr.8 Rrregullore e Zyrës së Karrierës</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të	Në takimin e realizuar me sekretarinëmësimore, zyrën e këshillimit të karrierës, GVJ konstatoi se studentët në mënyrë të vazhdueshme në formë elektronike në faqen zyrtare të institucionit, dhe nëpërmjet sekretarisëmësimore, zyrës së këshillimit të karrierës informohen për

<p>studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>ecurinë e programit mësimor.</p> <p><i>Ref. Dok. Nr.99 Rregjistër kursi MP Fizioterapi</i>  <i>Ref. Dok. Nr.8 Rregullore e këshillimit të karrierës</i>  <i>Ref. Google classroom manuali i studentit</i>  <i>Ref. Vizita në institucion</i>  <a href="http://www.unireald.edu.al">www.unireald.edu.al</a></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Institucion krahas ecures së programit të studimit në mënyrë të vazhdueshme zyra e këshillimit dhe karrierës mban lidhje dhe orienton studentët në tregun e punës.</p> <p>Po ashtu institucion ndihmon bazuar dhe në marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione shëndetësore të ndryshme publike dhe jo publike ndjekjen dhe dokumentimin e praktikës profesionale, të dokumentuar në bllokun e praktikave.</p> <p>Takimi me studentët nuk u realizua, pasi nuk kishte student ditën që GVJ realizoi vizitën në institucion.</p> <p><i>Ref. Dok. Nr.8 Rregullore e këshillimit të karrierës</i>  <i>Ref. Dok. Nr 25 Marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin e Fogias</i>  <i>Ref. Dok. Nr 27 Marrëveshje bashkëpunimi me Spitalin Rajonal Vlorë</i>  <i>Ref. Dok. Nr 28 Marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin e Mjekësisë Tiranë</i>  <i>Ref. Dok. Nr 29 Marrëveshje bashkëpunimi me institucione për realizimin e praktikave mësimore</i>  <i>Ref. Dok. Nr.42 Portofoli i praktikës profesionale</i>  <i>Ref. Dok. Nr.51 Studim tregu në fushën e shëndetësisë</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve, organeve dhe autoriteteve drejtuese përkatëse</p>	<p>Zyra e këshillimit të karrierës bazuar dhe në rregulloren e funksionimit të saj, ndjek ecurinë e studentëve jo vetëm për realizimin e programit mësimor, por dhe për orientimin, punësimin e tyre në institucione të ndryshme shëndetësore publike dhe jo publike. Zyra e karrierës në mënyrë të vazhdueshme studion dhe tregun e punës, për të ndihmuar studentët që diplomohen për integrimin e tyre në tregun e punës.</p> <p><i>Ref. Dok. Nr.8 Rregullore e këshillimit të karrierës</i>  <i>Ref. Dok. Nr.32 Studentë të diplomuar MP Fizioterapi</i>  <i>Ref. Dok. Nr.51 Studim tregu në fushën e shëndetësisë</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b></p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER PROFESIONAL

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Institucioni bazuar në statutin e institucionit, Rregulloren e Fakultetit të Shkencave Mjekësore si dhe Rregulloren e funksionimit të NJSBC-së, zotëron struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi. Gjithashtu IAL kryen këtë vlerësim në forma të ndryshme: - nëpërmjet plotësimit të pyetësorëve në mënyrë elektronike nga ana e studentëve.</p> <p><i>Ref. Dok. Nr.2 Statuti i KU "Reald"</i>  <i>Ref. Dok. Nr.5 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Mjekësore, Kreu 7</i>  <i>Ref. Dok. Nr.6 Rregullore e NJSBC</i>  <i>Ref. Dok. 86 Pyetësor për studentin. Formular vlerësimi për aktivitetin e NJSBC</i>  <i>Ref. Dok. 87 Pyetësor. Formular NJSBC Vlerësim i studentit për pedagogët</i>  <i>Ref. Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorët e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Universiteti "Reald" ka një Njësi të Vlerësimit të Brendshëm të cilësisë e cila përbëhet nga 5 anëtarë. Kjo njësi kontrollon paraqet Rektorit një raport vjetor mbi aktivitetin mësimor, kërkimorë dhe mbi shërbimet e ofruara nga IAL-ja. Njëkohësisht është përgjegjëse për mbledhjen, menaxhimin, ruajtjen dhe komunikimin e mendimeve të studnetëve për mësimdhënien që është dhënë. Për realizimin e funksioneve të saj Njësia bazohet në rregulloren e funksioneve të Njësies së Vlerësimit dhe ka të drejtën e aksesit në të gjitha dokumentet, dhe informacionet e tjera të Universitetit dhe në të njëjtën kohë të ruajë konfidencialitetin e dokumenteve të mbledhura.</p> <p><i>Ref. Dok. Nr.6 Rregullore e NJSBC</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e</p>	<p>Njësia e Sigurimit të Brendshëm për Vlerësimin e Cilësisë është e përbërë nga 5 anëtarë nga të cilët 3 janë përfaqësues të njësies kryesoret, një përfaqësues i studentëve dhe një përfaqësues i jashtëm. Ne konstatojmë se institucioni përdor në nivel operacional:</p> <p>a) pyetësorët tek studentët për mbledhjen e të dhënave lidhur me aspekte të ndryshme të veprimtarisë mësimore e asaj administrative, në përputhje kjo me pikat 3 &amp; 4 të nenit 103 të Ligjit 80/2015;</p>

<p>krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>b) pyetësorët tek studentët nga NJSBC për pedagogët Në aspektin taktik, institucioni përdor: a) raportime tek drejtuesit; Sa i përket aspektit strategjik, NJSBC ka gjeneruar informacion sasiore dhe cilësore, për të ardhur në ndihmë GVJ në ndihmë të akreditimit të jashtëm, në përputhje me parashikimet e Ligjit 80/2015 në këtë aspekt.</p> <p><i>Ref. Dok. Nr.2 Statuti i KU "Reald"</i> <i>Ref. Dok. Nr.5 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Mjekësore</i> <i>Ref. Dok. Nr.6 Rregullore e NJSBC</i> <i>Ref. Dok.86 Pyetësor për studentin. Formular vlerësimi për aktivitetin e NJSBC</i> <i>Ref. Dok.87 Pyetësor, Formular NJSBC Vlerësim i studentit për pedagogët</i> <i>Ref. Vizitë në institucion</i></p>								
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>GVJ nisur nga RVB, vizita dhe takimet institucionale mendon se IAL-ja, ofron në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë ka një politikë të qartë. Gjithashtu, synon krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit. Gjata takimeve rezultoi se fokusi kryesor i stafit akademik dhe drejtuesve janë elementet e mësimdhënies dhe mësimnxënies, duke specifikuar elementet përbërës të moduleve, krediteve, bazës së nevojshme didaktike për realizmin e programit të studimit, literaturës së përdorur, pavarësisht se për programin e studimit MP Fizioterapi, nuk kishte literaturë të nevojshme për lëndët dhe modulet profesionale</p> <p><i>Ref. Dok. Nr.2 Statuti i KU "Reald"</i> <i>Ref. Dok. Nr.5 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Mjekësore</i> <i>Ref. Dok. Nr.6 Rregullore e NJSBC</i> <i>Ref. Vizita në institucion</i></p>								
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="560 1473 786 1541">Nuk përmbushet</th> <th data-bbox="791 1473 986 1541">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="991 1473 1203 1541">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1208 1473 1430 1541">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="560 1541 786 1574"></td> <td data-bbox="791 1541 986 1574"></td> <td data-bbox="991 1541 1203 1574" style="text-align: center;">X</td> <td data-bbox="1208 1541 1430 1574"></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

**Standardi VI.2**

**Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njëjësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të nxënësve.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikqyerjen, rishikimin e</p>	<p>GVJ mendon se në institucion ekzistojnë dhe janë funksionale njësi specifike përgjegjëse për monitorimin, shqyrtimin, mbikqyerjen, rishikimin e programit të studimit. Këto njësi nëpërmjet kontrollit të</p>

<p>programeve të studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>vazhdueshëm të mekanizmave të procesit mësimor evidentojnë dhe përmirësojnë problematikat kryesore të lidhura me studentët dhe kurrikulën.</p> <p><i>Ref. Dok. Nr.6 Rregullore e NJSBC</i>  <i>Ref. Dok. Nr.46 Plan masash për zbatimin e rekomandimeve të Bordit të Akreditimit</i>  <i>Ref. Dok. Nr.73 Relacion përfundimtar. Rekomandimet të plotësuara MP Fizioterapi</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>GVJ bazuar në RVB dhe dokumentat e vëna në dispozicion konstaton se: Në raportin e Zyrës së Statistikës, që mbështet NJSBC në funksionimin e saj, prezantohet pyetësi për studentët që, përmes pyetjeve që lidhet me programin e studimit në fjalë dhe infrastrukturën, gjithashtu konstatoi se, në institucion u informua se program i Fizioterapisë pëson ndryshime, bazuar në ndryshimet vjetore sipas udhëzimeve të MASR, për ndryshim të programit rreth 20% cdo vit, si duke e përshtatur dhe me programin e partnerëve që ka dhe bashkëpunim</p> <p><i>Ref. Dok. Nr 74 Shkrsë Nr 93 datë 22/06/2020 drejtuar MASR, mbi riorganizimin e programit MP Fizioterapi.</i>  <i>Ref. Dok. Nr 75 Kthim përgjigje nga MASR Nr 2877.4 datë 01/07/2020 mbi miratimin e riorganizimit të dy programeve të ciklit të dytë</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>GVJ nga raportet e depozituara dhe të cituara në kriteret e mësipërme, ai i Zyrës së Statistikës detajon në njëfarë mase metodologjinë e përdorur për të mbledhë dhe analizuar përgjigjet e studentëve në pyetësorët respektivë. Në raportin e NJSBC janë përdorur indikatorë për performancën e studentëve në rang Universiteti, përfshirë edhe ata në programin e studimit të MP Fizioterapisë. Për shkak se mungojnë raportet ndër vite është e pamundur të konkludohet për stabilitetin e metodologjisë dhe aplikimin e saj rigoroz vit pas viti, sikurse e kërkojnë aktet rregullatore.</p> <p><i>Ref. Dok. Nr.6 Rregullore e NJSBC</i>  <i>Ref. Dok. Nr. 86 Pyetësor për studentin. Formular vlerësimi për aktivitetin e NJSBC</i>  <i>Ref. Dok. Nr. 87 Pyetësor, Formular NJSBC Vlerësim i studentit për pedagogët</i>  <i>Ref. Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi se, të gjitha të dhënat e grumbulluara dhe të shfrytëzuara për ndryshimet në funksion të rritjes së cilësisë ruhen dhe i paraqiten Rektorit dhe Senatit Akademik nga Njësia e Vlerësimit të brendshëm në një raport vjetor mbi veprimtaritë e mësimdhënies, të</p>



	<p>kërkimit shkencor, mbi shërbimet e kryera nga Universiteti.</p> <p>Po ashtu, kjo njësi raporton në lidhje me rezultatet e shprehura nga studentët, si edhe mbi nivelin e funksionalitetit dhe efikasitetit të arritur nga njësitë e ndryshme organizative.</p> <p>Në raportin e vet vjetor, nxjerr në dukje praktikën e mira dhe rekomandimet i paraqet rektorit dhe Senatit rekomandimet për vitin akademik pasardhës.</p> <p><i>Ref. Dok. Nr.6 Rregullore e NJSBC</i>  <i>Ref. Dok. Nr 89 Raport vjetor i NJSBC për 2019-2020</i>  <i>Ref. Dok. Nr 90 Raport vjetori Qendrës Kërkimore 2019-2020</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë</p>	<p>GVJ duke ju referuar dokumentacionit bashkëlidhur në RVB po edhe gjatë takimeve me Zyrën e Statistikës dhe Njësinë e Vlerësimit të Brendshëm të Cilesisë, në përputhje me Rregulloren e vet, kjo njësi përgatit një raport vjetor lidhur me cilësinë e mësimdhënies të cilin ja paraqet Rektorit së bashku me rekomandimet e bëra.</p> <p><i>Ref. Dok. Nr.6 Rregullore e NJSBC</i>  <i>Ref. Dok. Nr 89 Raport vjetor i NJSBC për 2019-2020</i>  <i>Ref. Dok. Nr 90 Raport vjetor i Qendrës Kërkimore 2019-2020</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

### Standardi VI.3

**Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>GVJ gjatë takimit me drejtuesit e institucionit u informua se, ky institucion, në mënyrë periodike bën vlerësim të brendshëm të programit të studimit MP Fizioterapi. Vlerësimi bëhet duke u mbështetur në legjislacionin në fuqi, duke mbledhur dhe mendimet e stafsfit akademik, studentëve.</p> <p><i>Ref. Dok. Nr 44 Programi mësimor i MP Fizioterapi i riorganizuar në masën 20%</i>  <i>Ref. Dok. Nr 45 Shtojca me rekomandimet e vendimit nr 17 datë 24/2/2020 i BA</i>  <i>Ref. Dok. Nr 74 Shkresë Nr 93 datë 22/06/2020 drejtuar MASR, mbi riorganizimin e programit MP Fizioterapi</i>  <i>Ref. Dok. Nr 75 Kthim përgjigje nga MASR Nr 2877.4 datë 01/07/2020 mbi miratimin e riorganizimit të dy programeve të ciklit të dytë</i></p>

<p><b>Kriteri 2.</b> Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>GVJ në takimin me stafin drejtues të institucionit u njoh me disa metoda, instrumente që përdor institucioni për vlerësimin e programit të MP të Fizioterapisë konstaton se institucioni përdor metodat dhe instrumentet për vlerësimin e programit mësimor. Disa nga keto metoda janë intervistat e strukturuar ose pyetësorët nëpërmjet postës elektronike. Një mënyrë tjetër është nëpërmjet takimeve të drejtpërdrejta të mbajtura nga Koordinatori i program të studimit me studentët. Takimet me studentët janë të nevojshme për monitorimin në kohë reale nga ana e institucionit, e procesit të të nxënit, e vlerësimit të procesit të cilësisë së mësimdhënies dhe e personelit administrative. Në takim mungonin studentët e MP Fizioterapisë.</p> <p><i>Ref. Dok. Nr.6 Rregullore e NJSBC</i>  <i>Ref. Dok. Nr. 89 Raport vjetor i NJSBC për 2019-2020</i>  <i>Ref. Dok. Nr. 86 Pyetësor për studentin. Formular vlerësimi për aktivitetin e NJSBC</i>  <i>Ref. Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni i arsimit të lartë, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda të drejtpërdrejta, si: vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>GVJ në takimet e realizuara në institucion ashtu sic u përmend dhe më lartë përdor metoda të drejtpërdrejta (takime me studentët, pyetësor on-line, vëzhgimit të procesit mësimor drejtpërdrejt ose me anë të sistemit të kamerave), për vlerësimin e mbarëvajtjes së programit të studimit si (plani mësimor, mësimdhënia, infrastruktura e ambienteve, auditore, laboratore, biblioteka, mënyra e vlerësimit etj</p> <p><i>Ref. Dok.Nr.2 Statuti i KU "Reald</i>  <i>Ref. Dok.Nr.5 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Mjekësore</i>  <i>Ref. Dok.Nr.6 Rregullore e NJSBC</i>  <i>Ref. Dok.Nr.9 Rregullore e diplomimit</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë</p>	<p>Sikurse kemi theksuar edhe në kriteret e mësipërme IAL përdor pyetësor për shprehjen e mendimeve për stafin akademik dhe studentëve për sa i përket vlerësimit të dijeve dhe kompetencave të përfituara nga programi. Institucioni për të rritur cilësinë e programit të studimit bashkë punon me NJSBC.NJSBC planifikon organizimin e vlerësimit të brendshëm të cilësisë të programeve të studimit dhe të vlerësimit të brendshëm institucional. Për të realizuar këtë duhet të ngrihet grupi i vlerësimit të brendshëm, ku merr pjesë edhe një përfaqësues nga organizata studentore. Në rast nevojë, ftohet një përfaqësues ekspert i jashtëm me përvojë të gjere akademike. Grupi i</p>

në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.

vlerësimin të brendshëm ka autonomi operative dhe akses në të gjitha të dhënat e institucionit. Vlerësimi i brendshëm duhet të realizohet në përputhje me udhëzimet përkatëse të ASCAL si dhe në Rregulloren e funksionimit të NJSBC. Po ashtu institucioni zotëron një formular vlerësimi për aktivitetin më simor, pyetë sor me 8 pyetje i cili plotësohet nga studentët dhe është anonim, referuar, evidence Nr.87. Formular vlerësimi i studenteve për pedagogun dhe lëndën, në kuadrin e sigurimit të cilësisë së procesit mësimor, institucioni ka hartuar këtë pyetësor, referuar, evidence Nr.88.

Formulari i vetëvlerësimin të performancës së personelit akademik i realizuar nga njësia e brendshme e sigurimit të cilësisë referuar, evidence nr.89.

Në kuadrin e sigurimit të cilësisë së procesit mësimor, mësimdhënies, jetës studentore institucioni ka hartuar disa pyetësor si më lart. Konkluzionet e vlerësimin të brendshëm duhet të mbështeten në analizën statistikore të të dhënave, në konstatimet e nxjerra nga regjistrat, në sondazhet, pyetësorët dhe intervistat e organizuara me stafin akademik, stafin joakademik dhe studentët.

*Ref. Dok. Nr.6 Rregullore e NJSBC*

*Ref. Dok. Nr.87 Pyetësor për studentin. Formular vlerësimi për aktivitetin e NJSBC*

*Ref. Dok. Nr.88 Pyetësor. Formular NJSBC Vlerësim i studentit për pedagogët*

*Ref. Dok. Nr.89 Formulari i vetëvlerësimin të performancës së personelit akademik*

**Shkalla e përmbushjes së standardit**

Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

**Standardi VI.4**

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.**

**Kriteret**

**Vlerësimi i ekspertëve**

**Kriteri 1.** Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.



GVJ bazuar në RVB, në ligjin 80/2015 neni 103, VKM 531 dt 11.9.2018 (Kodi i Cilësisë) Statutin instiucional si dhe duke referuar rregullores së NJSBC konstatohet se është ngritur struktura për sigurimin e brendshëm të cilësisë në bazë universiteti dhe janë parashikuar rregullat e procedurat për funksionimin e saj. Në përbërje të NJSBC është përfshirë një ekspert i jashtëm dhe 4 të brendshëm: 1 student dhe 3 staf akademik.

*Ref. Dok. Nr.2 Statuti KU "Reald"*

	<p><i>Ref. Dok.Nr.5 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Mjekësore</i>  <i>Ref. Dok.Nr.6 Rregullore e NJSBC</i>  <i>Ref. Dok.Nr.23. Të dhëna mbi përbërjen e NJSBC. Vendimi nr1. 18/10/2019 Miratim structure NJSBC dhe ZBNJ</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Rregullorja e NJSBVC parashtron detyrat për strukturat e përfshira në garantimin e brendshëm të cilësisë. Rregullat e parshikuara janë të qarta bazuar dhe në rregulloren e funksioneve të Njësisë së Vlerësimit.</p> <p><i>Ref. Dok. Nr.6 Rregullore e NJSBC</i>  <i>Ref. Dok.Nr 86 Pyetësor për studentin. Formular vlerësimi për aktivitetin e NJSBC</i>  <i>Ref. Dok.Nr 89 Raport vjetor i NJSBC për 2019-2020</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>GVJ bazuar në RVB si dhe dokumenta të vëna në dispozicion nga institucioni garantohet përfshirja në vlerësimin e programit MP Fizioterapi I grupeve të interes: përgjegjësit të programit të studimit, personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.</p> <p>Ky takim nuk u realizua në institucion, pasi mungonin stafi pedagogjik i angazhuar në mësimdhënie në programin MP Fizioterapi, po ashtu mungonin studentët për takimin sipas agendes së vizitës.</p> <p><i>Ref. Dok. Nr.6 Rregullore e NJSBC</i>  <i>Ref. Dok.Nr 86 Pyetësor për studentin. Formular vlerësimi për aktivitetin e NJSBC</i>  <i>Ref. Dok.89 Raport vjetor i NJSBC për 2019-2020</i>  <i>Ref. Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Nga takimet me përfaqësues të NJSBC nuk u konstatuan ankesa apo raportime në këtë drejtim.</p> <p>Njëkohësisht nga baza dokumentare dhe RVB nuk konstatohen elemente që të krijojnë dyshime për trajtim diskriminues në përfshirjen e dhe aktivizimin sa i përket proceseve vlerësuese. Pyetësorët deklarohen nga koordinatori se janë anonim dhe në raportin e NJSBC del se në Zyrën e Statistikës nuk përmbahen emra me kontekst denigrues, fyes apo diskriminues, në respektim të Kodit të Etikës.</p> <p><i>Ref. Dok. Nr.6 Rregullore e NJSBC</i>  <i>Ref. Dok.Nr 86 Pyetësor për studentin. Formular vlerësimi për aktivitetin e NJSBC</i>  <i>Ref. Dok.89 Raport vjetor I NJSBC për 2019-2020</i>  <i>Ref. Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e</p>	<p>Institucioni organizon procedura për krahasimin dhe përfshirjen midis</p>

<p>procese të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj</p>	<p>aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të Universitetit. Eksperti i jashtëm të cilët përfshihen në vlerësimin e cilësisë së programit të studimit mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj. Në përfundim, të gjithë aktorët e Programit të Studimit të MP në Fizioterapi, personeli teknik administrative dhe pedagogët, janë të përfshirë dhe përgjegjës në proceset të ndryshme të menaxhimit dhe zhvillimit të programit të studimit nëpërmjet konsultimeve, takimeve periodike.</p> <p>Përveç vlerësimit të brendshëm, element tjetër i sigurimit të cilësisë është dhe vlerësimi i jashtëm i cili koordinohet nga ASCAL.</p> <p>Ky vlerësim kryhet nëpërmjet hartimit të raporteve të vlerësimit, ku pasqyrohet gjendja aktuale dhe jepen rekomandime me qëllim përmirësimin dhe përmbushjen e standardeve të cilësisë.</p> <p><i>Ref. Dok. Nr.6 Rregullore e NJSBC</i>  <i>Ref. Dok. Nr.23. Të dhëna mbi përbërjen e NJSBC. Vendimi nr1. 18/10/2019 Miratim structure NJSBC dhe ZBNJ</i>  <i>Ref. Dok. Nr 89 Raport vjetor i NJSBC për 2019-2020</i>  <i>Ref. Dok.Nr 45 Shtojca me rekomandimet e vendimit nr 17 datë 24/2/2020 i BA</i>  <i>Ref. Dok.Nr.73. Pika 11. Relacioni përfundimtar. Rekomandimet e plotësuara për MP Fizioterapi</i>  <i>Ref. Vizitë në institucion</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p><b>Standardi VI.5</b>  <b>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të SBC për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>GVJ bazuar në evidencat e vëna në dispozicion konstaton se Institucioni e ka në vëmendje të politikave të ndryshme dhe veprimtarinë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë.</p> <p>GVJ konstatoi se NJSBC, është e përpiluar në përputhje me Rregulloren mbi funksionet e njësisë së vlerësimit të cilësisë si dhe ligjin mbi privatësinë dhe etikën akademike.</p> <p>NJSBC harton raportin e punës së vet, dhe jep rekomandime të shoqëruara me një analizë përmbledhëse .</p> <p>Këto rekomandime janë shumë të rëndësishme për autoritetet vendimmarrëse të Universitetit, pedagogët si dhe studentët, në mënyrë që problematikat të konstatohen në kohë reale dhe po kështu</p>

	<p>zgjdhja e tyre të bëhet në kohë reale. NJSBC e paraqet raportin vjetor në Rektorat dhe në Senatit dy organe të rëndësishme vendimmarrëse të Universitetit.</p> <p><i>Ref. Dok. Nr.6 Rregullore e NJSBC</i> <i>Ref. Dok. Nr.23. Të dhëna mbi përbërjen e NJSBC. Vendimi nr1. 18/10/2019 Miratim structure NJSBC dhe ZBNJ</i> <i>Ref. Dok. Nr 89 Raport vjetor i NJSBC për 2019-2020</i></p>			
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>GVJ konstatoi sic e kemi përmendur dhe në standartet e mësipërme në transparencë në publikimin e rezultateve të vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p> <p><i>Ref. Dok. Nr.66 Vendim i Senatit Akademik Nr 34. Datë 9/5/2020 për miratim e Rregullores për mbrojtjen e të dhënave personale.</i></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>GVJ konstatoi bazuar në RVB, në takimet me grupet e interesit se cdo raport mbi Vlerësimin e Brendshëm të Cilësisë shërben dhe shoqërohet me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive apo dobësive të evidentuara në këtë program studimi.</p> <p><i>Ref. Dok. Nr.6 Rregullore e NJSBC</i> <i>Ref. Dok. Nr 89 Raport vjetor i NJSBC për 2019-2020</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Po kështu GVJ vuri re në bazë të dokumentave se institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive të realizuara nga njësi bazë, e cila ndikon në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit MP në Fizioterapi.</p> <p><i>Ref. Dok. Nr.6 Rregullore e NJSBC</i> <i>Ref. Dok. Nr 89 Raport vjetor i NJSBC për 2019-2020</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit</p>	<p>Gjatë takimit me drejtuesit e institucionit, GVJ konstatoi se institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit të Diplomës MP në Fizioterapi, por takimi me stafin dhe studentët nuk u realizua, pasi nuk ishin të pranishëm në institucion gjatë guidës që GVJ realizoi në institucion.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Shkalla e përmbushjes së</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
---------------------------------	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	------------------------------

standardeve të fushës VI			X	
--------------------------	--	--	---	--

---


Adresa: "Rruga e Durrësit", nr. 219, Tiranë

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 71



**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në “Fizioterapi” të institucionit të arsimit të lartë Kolegji Universitar “Reald”**

**Pikat e forta dhe afirmime**

1. I vetmi institucion privat i arsimit të lartë, në rajonin e jugut që ofron këtë program studimi.
2. Kolegji Universitar “RELAD”, nga vrojtimi i dokumentacionit, dëshmon qëndrueshmëri financiare, gje e cila ndihmon dhe ndikon drejtë për drejtë në përmirësimin e programit të studimit (blerjen e pajisjeve të duhuar në funksion të këtij programi studimi ose mundësimin e trajnimeve për stafin akademik për të rritur cilësinë e mësimdhënies).

**Pika të dobta**

1. Numri i ulët i personelit akademik të brendshëm me tituj dhe grada të angazhuar në këtë program studimi, si dhe në këtë program studimi ka të angazhuar staf akademik me Msc.
2. Fusha akademiko-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e disa prej anëtarëve të personelit akademik që mbulon këtë program studimi, nuk është në përputhje të plotë me natyrën dhe specifikën e moduleve të këtij programi studimi.
3. Në plani mësimor, nuk është i qartë, ekuivalentimi i një krediti me orë mësimor për zërat: leksion, seminar, laborator, praktika profesionale.
4. GVJ konstaton se në disa raste syllabuset e lëndëve nuk janë përshtatur/përdituar në përputhje me aktet ligjore në fuqi.
5. Mungesa e një kabineti me aparatura/pajisje të përshtatshme/moderne për realizimin e mësimdhënies për studentë këtij programi studimi.
6. Literaturë e kufizuar për lëndët profesionale të këtij programi studimi, (shqip dhe në gjuhë të huaj) në bibliotekën e institucionit.
7. Disa nga rekomandimet e lëna nga akredimi i parë nuk janë plotësuar, edhe pse institucioni pohon se ka bërë përpjekjet e nevojshme.


**Rekomandime**

1. KUR, të marrë masa të menjëhershme për rekrutimi e personelit akademik me tituj dhe grada, me qëllim angazhimin në këtë program studimi të personelit akademik në përputhje të plotë me natyrën dhe specifikën e këtij programi studimi.
2. Të rris mbështetjen e personelit akademik, duke ju mundësuar atyre trajnime në fushën e fizioterapisë apo pjesmarrje në konferenca në këtë fushë, me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të metodave të mësimdhënies dhe jo vetëm.
3. Rrritja e numrit të studentëve nëpërmjet reklamimit të këtij programi, avantazhet, punësimi, cilësia e mësimdhënies etj.





4. Prania e stafit mësimdhënës në takimet institucionale si dhe i studentëve të këtij programi studimi, për të shprehur mendimet konkrete të mbarëvajtjes së këtij programi studimi.
5. Institucioni të përmirësoj më tej dosjet e stafit akademik duke i plotësuar ato me të gjitha dokumentat e nevojshme.
6. Institucioni, të rrisë investimet për bibliotekën duke akorduar një fond të veçantë për paisjen e bibliotekës fizike dhe on-line, me literaturën e lëndëve profesionale të këtij programi studimi.
7. Shpërndarja e ngarkesës mësimore të kryhet sipas legjislacionit në fuqi Udhëzimin Nr. 29, datë 10/09/2018 “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në IAL.
8. Institucioni, të shikoj mundësinë e krijimit të kabinetit modern për realizimin cilësor të planit mësimor të këtij programi studimi (ose të përmirësoj më pajisjet e fundit kabinetin ekzistues).
9. Institucioni, të marrë masa të menjëhershme për përmbushjen e rekomandimeve të lënë nga Bordi i Akreditimit që në akreditimin e parë të specifikuar në hyrje të këtij raporti.



## **Conclusions of the study program Evaluation of the second cycle Professional Master in "Physiotherapy" of the institution of higher education "Reald" University College**

### **Strengths and affirmations**


1. The only private institution of higher education in the southern region that offers this study program.
2. "REALD" University College, from the review of documentation, proves financial stability, which helps and directly affects the improvement of the study program (purchase of appropriate equipment for this study program or the provision of training for academic staff to enhance the quality of teaching).

### **Weak points**


1. The low number of internal academic staff with titles and degrees engaged in this study program, also in this study program are engaged academic staff with MSc.
2. The general and specific academic-research field for some of the members of the academic staff that covers this study program, is not in full accordance with the nature and specificity of the modules of this study program.
3. In the curriculum of this study program, it is not clear, the equivalence of a credit with teaching hours for the items: lecture, seminar, laboratory, professional practice.
4. The external evaluation group finds that in some cases the syllabus of subjects have not been adapted / updated in accordance with the legislation in force.
5. Lack of a cabinet with appropriate / modern apparatus / equipment for the realization of teaching for students of this study program.
6. Limited literature for professional subjects of this study program, (Albanian and in foreign languages) in the library of the institution.
7. Some of the recommendations left by the first accreditation have not been met, although the institution claims to have made the necessary efforts.

### **Recommendation**

1. "REALD" University College must take immediate measures for the recruitment of academic staff with titles and degrees, in order to engage in this study program, academic staff in full accordance with the nature and specificity of the this study program.
2. To increase the support of academic staff, by providing them with training in the field of physiotherapy or participation in conferences in this field, in order to further improve teaching methods.
3. Increasing the number of students through advertising of this program, advantages, employment, quality of teaching, etc.



4. The presence of the teaching staff in the institutional meetings as well as of the students this study program, to express the concrete opinions of the progress of this curriculum.
5. The institution to further improve the files of the academic staff by completing them with all the necessary documents.
6. To increase investments for the library by allocating a special fund for equipping the physical and on-line library, with the literature of professional subjects this study program.
7. Distribution of teaching load to be performed according to the applicable legislation Instruction no. 29, dated 10/09/2018 "On the activity and teaching load of the academic staff in the HEI.
8. To look at the possibility of creating a modern cabinet for the quality realization of this study program curriculum (or to upgrade the existing cabinet with the latest equipment).
9. To take immediate measures to fulfill the recommendations left by the Accreditation Board since the first accreditation specified in the introduction of this report.



**Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
		Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT			X	
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT		X		
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT			X	
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE			X	
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE			X	
<b>VLERËSIMI TËRËSOR</b>			X	

